

Mjekët kishin harruar ilaçet për të shpëtuar Denisin

PS "merr" doganën e Durrësit, në krye Konomi

Kombëtarja, De Biazia kërkon 1 milion euro

Kursime në administratë qeveria favor deputetëve

# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI III - NR. 238 E martë, 08-10-2013



Flet presidenti i shoqatës së ushtarakëve në rezervë Mehdi Pogaçi

## PENSIONI I USHTARAKEVE

### "RAMA E PREMTOI, TANI ANULONI LIGJIN E BERISHES"

Nga shfuqizimi i Aktit Normativ përfitojnë 7500 ushtarakë, të cilët janë penalizuar me uljen e pagesës. Pogaçi thotë se janë gati për konsensus me qeverinë, sipas premtimit të kryeministrit

▶ Faqe 4-5

NE A1 REPORT

▶ Faqe 6



**Genc Ruli:**  
Administrata tani duhet çpolitizuar

URDHRI I FUNDIT

▶ Faqe 2-3



### Gardistët pa pistoleta në shtëpi

Për arsye sigurie vetëm oficerët të armatosur jashtë shërbimit

Satirë



NGA ARBEN DUKA

Epërsia e pashoqe e dashurisë..

(Sipas Biblës-Dhjata e Re; nga letra e parë e Shën Pallit dërguar korintasve)

Dhe po të isha më i miri, pa dashuri do isha kot, do isha një këmbanë floriri, që asnjë tingull nuk nxjerr dot!

▶ vijon në faqen 16 edhe me një poezi tjetër

Ndryshe



NGA EDISON YPI

Veza e kuqe

Këta vetëm vezë të kuqe bëjnë. Këta ta shpifin me gjithë këto vezë dhe gjithë këtë të kuqe. Këta e kanë mbushur Shqipërinë me vezë të kuqe,...

▶ vijon në faqen 17

Koment



NGA ARBEN SALIU

Etërit dhe bijtë

Pas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 23 qershorit, jo rrallë herë nga krahu i djathtë është lëshuar në drejtim të krahut tjetër fjalia... ▶ vijon në faqen 17

REKLAMAT

## Agjencia e PD fitoi tenderin e skandalit

Pas katër arrestimeve në Ministrinë e Punës zbardhet skema

OKR	
EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTI "SHOQËRI ME PËRÇJEGJËSI TË KUFIZUAR"	
GJENDIA E REGJISTRIMIT	
1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NSPD)	K025060030
2. Data e themelimit	MC
3. Emri i Subjektit	MC
4. Emri i Subjektit	MC
5. Forma ligjore	MC
6. Të drejtat e subjektit	Driton Sahiti Nga: 01/10/2009 Deri: 01/10/2014
7. Të drejtat e subjektit	Ebis Themeli 8.550,00 30,00
12. Partitëtarët ligjor	Alfiu Lemeritani Nga: 01/10/2009 Deri: 01/10/2014
13. Kofunduesit si kompetencave	Ebis Themeli 8.550,00 30,00
14. Oriantimi	Ebis Themeli 8.550,00 30,00
15. Oriantimi	Ebis Themeli 8.550,00 30,00

TIRANE

GENC KONDI

A buzimi korruptiv me fondet e ministrisë së punës dhe Çështjeve Sociale, zbuluar së fundi nga Prokuroria e Tiranës, pas akuzës së një shtetaseje, që ishte e punësuar më parë në atë dikaster, është kryer me ndërmjetësinë e një kompanie, tashmë të njohur si fituese e shumë tenderave të përfolur, si koncerti i Rita Orës, festimet me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, etj. Të gjitha këto evente janë përballuar... ▶ Faqe 9

INTERVISTA ▶ Faqe 3

**Rama: Deri sot gjykata ka qenë faltore e korrupsionit**



**NERANXI**  
... gjithmonë një hap përpara...  
**Ushqime aziatike dhe meksikane**  
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshok Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



## Nishani, sot me krerët e grupeve parlamentare

Në kuadër të nisjes së procedurës së përzgjedhjes së Kryetarit të ri të Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës do zhvillojë sot takime konsultative me krerët e Grupeve Parlamentare. Kështu, në orën 10:00 do takojë kryetarin e Grupit Parlamentar të PS, Gramoz Ruçi, në orën 10:45 takon kryetarin e Grupit Parlamentar të PD, Edi Paloka,

në orën 12:30 takon kryetarin e Grupit Parlamentar të LSI Petrit Vasili, në orën 13:30 takon kryetarin e Grupit Parlamentar të PDIU Shpëtim Idrizi dhe në orën 14:30 takon kryetarin e Grupit Parlamentar të PR Fatmir Mediu. Takimi zhvillohet në kuadër të konsultimeve për emrin e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, pasi kreut aktual Bashkim Dedja i ka përfunduar mandati

tre vjeçar. Gjithashtu po sot në ora 11:35, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani do të zhvillojë një takim me ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Lituaniës, Linas Linkevičius, në kuadër të Presidencës së Radhës të Bashkimit Europian dhe ministrin e Puneve të Jashtme të Rumanisë, Titus Corlatean në kuadër të Presidencës së Rumanisë në SEECP.

# Vendosen shkurtime për shpenzimet e transportit Kursimet, qeveria favorizon deputetët

Për zyrtarët shkurtohen 15 mijë lekë, për deputetë 5 mijë

## LAJMI

Qeveria ka miratuar një vendim sipas të cilit ulen shpenzimet për transportin e deputetëve, zv.ministrave dhe drejtorëve të enteve rregullatore duke kursyer 165 milionë lekë në vit. Nuk preken ministrat dhe krerët e institucioneve Kushtetuese.

## TIRANE

JAKIN MARENA



Automjete të deputetëve

Kryetari i mazhorancës së majtë njëherësh kryeministër i vendit po mban premtimin elektoral për një lehtësim të shpenzimeve për shërbimet të zyrtarëve të lartë të shtetit. Në këtë mënyrë shpenzimet e transportit për funksionarët e lartë, një ndër elementët ku është shënuar një tarifë e lartë shpenzimi ka qënë "viktima" e parë e qeverisë së re, duke kursyer miliona lekë në vit, të cilat do të përdoren në sektorë të tjerë shërbimesh në favor të qytetarit. Kështu, një ndër vendimet e para të qeverisë "Rama" me ndikim në buxhetin e shtetit ka qënë ai për uljen drastike të shpenzimeve të transportit për funksionarët publikë si dhe nëpunësit civil. Ky shkurtime shpenzimesh është përfshirë në një projektligj të qeverisë që ka si qëllim disiplinimin e shpenzimeve të transportit për një sërë funksionarësh që konsiderohen të kategorisë së dytë. Sipas këtij projektligji çdo deputet, parvësisht largësisë nga zona e tij elektoral, nuk do të shpenzojë më shumë se 40 mijë lekë në muaj për transportin e tij, nga rreth 45 mijë lekë që ishte limiti më parë. Ndërsa funksionarët e tjerë, këtë kufi do ta kenë 20 mijë lekë nga 35 mijë që e kanë aktualisht. Ndërkohë që zv.ministrat do të kenë një kuotë për shpenzime transportit që nuk i kalon të 15 mijë lekët në muaj. Në këtë dokument nuk përf-

## SHKURTIMET E SHPENZIMEVE PËR TRANSPORT NË MUAJ

Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë	nga 45 në 40 mijë lekë
Kryetari Autoritetit të Mbikqerjes Financiare	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Shërbimit Civil	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Inspektoratit të Deklarimit të Pasurisë	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve	nga 35 në 20 mijë lekë
Zv.kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	nga 35 në 20 mijë lekë
Kryetari i Agjencisë së Trajimit të Ujrave e pyjeve	nga 35 në 20 mijë lekë
Zv.ministrat e qeverisë	nga 25 në 15 mijë lekë

shihen ministrat, kryetari i Kuvendit apo krerët e institucioneve kushtetuese, si Kryeprokurori, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i Gjykatës së Lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve etj, të cilat quhen dhe funksionetë katego-

risë së parë. Në total shkurtime i shpenzimeve për transportin për funksionetë të tilla, kanë një efekt vjetor prej 165 milionë lekë të reja. Ky vendim pritet të nisë efektet pas hyrjes në fuqi në fletoren zyrtare, dhe duke pasur parasysh se është miratuar në qeveri por do të

kalojë nëpër komisione dhe më pas në Kuvend, i bie të hyjë në fuqi nga janari i vitit të ardhshëm. Por shkurtimeve të shpenzimeve nga ana e qeveritarëve tanë kanë nisur që në vitin 2009, kur kryeministri Berisha vendosi heqjen e makinave dhe shoferëve

për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Sipas llogaritjeve të qeverisë së asaj kohe një deputet i kushtonte buxhetit me makinën mirëmbajtjen dhe shoferin 19 mijë dollarë në vit, dhe me vendimin e qeverisë shkurtoheshin shumë shpenzimet e këtij lloji.

## PËRJASHTIMI

"S'përfshihen ministrat, kreu i Kuvendit, krerët e institucioneve kushtetuese, si Kryeprokurori, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i Gjykatës së Lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve etj, që quhen funksione të kategorisë së parë".



Mbledhje e Këshillit të Ministrave

## BASHKËQEVERISJA

### Emërimet, Dritan Ylli kreu i Inspektoratit të Punës

Pa ndërprerje po emërohen dhe drejtuesit e institucioneve të rëndësishme për qeverisjen e vendit, që janë në varësi të dikasterëve qëndrorë por që kanë një peshë specifike në jetën publike të vendit. Kështu, është emëruar në detyrë e Kryeinspektorit të Punës Dritan Ylli, përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim.



Dritan Ylli

Ky inspektorat varet direkt nga Ministria e Mirëqenies dhe Rinisë të drejtuar nga socialisti Erjon Veliaj dhe ka për detyrë të kontrollojë tërë tregun e punës në Shqipëri, nëse punohet sipas ligjit apo në të zezë. Ndërkohë që po një përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim është emëruar si Drejtor i Autoritetit Shëndetësor Rajonal në qarkun e Tiranës dhe ai është Edmond Stojku. Ndërsa mësohet nga burime të sigurta se pikërisht LSI do të jetë ajo që do të marrë dhe drejtimin e ISKSH, duke vënë në këtë post kyç një figurë të provuar në poste drejtuese në pushtetin qëndror dhe atë vendor.

## PD, Xhepa:

"Çdo masë për kursim duhet të vlerësohet"

As opozita nuk është kundër shkurtimeve publike nga ana e qeverisjes socialiste, teksa nënvizohet se nëse janë të studiuar dhe efikase ato duhet të përshëndeten në të gjitha rastet. Kështu, për ish-deputetin e Partisë Demokratike, Selami Xhepa, aktualisht ekspert ekonomik, çdo masë e marrë në drejtim të kursimeve publike vlen për t'u përshëndetur. Projektligji në fjalë që bën të ditur shkurtimeve të shpenzimeve të miratuar në qeveri pritet të bëhet objekt diskutimesh edhe në parlament. Një nisim të tillë të ngjashme e mori edhe qeveria e Berishës dhe deklarata e Xhepës paralajmëron se mund të mbështetet nga PD.





**Zaganjori: Efektivitet dhe transparencë kundër korrupsionit**

Kreu i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori ka dhënë dje në mbrëmje një intervistë për "Zërin e Amerikës", ku ka shprehur opsionet e tij për gjendjen në të cilën ndodhet gjyqësori në këto momentet dhe pa prekur pikat më të nxehta që e shetësojnë atë. Në këtë intervistë Zaganjori ka theksuar se korrupsioni mbetet shqetësim i qëndrueshëm, shumë i

madh dhe që kërkon të gjitha përpjekjet për ta luftuar dhe shënauar një rezultat pozitiv ndaj tij. "Duhet bashkëpunim me të gjithë mekanizmat për të luftuar korrupsionin. Duhet të rrisim transparencën dhe efektivitetin", tha kreu i Gjykatës së Lartë. Në lidhje me çështjen e Gërdecit, Zaganjori nuk ka dashur të komentojë rekursin e Gjykatës së Lartë për këtë çështje, duke u

shprehur se nuk kishte informacion mbi këtë fakt. "Nuk kam dijeni për rekursin e çështjes së Gërdecit. Unë nuk merrem me dhënien e drejtësisë, por administrimin", është shprehur Zaganjori, duke iu shmangur kësaj teme të nxehtë dhe tepër të prekshme jo vetëm për familjet e viktimave të Gërdecit por dhe për publikun shqiptar, tashmë kur kanë kaluar 5 vjet.

**Intervistë e Kryeministrit: Mund të kemi edhe më shumë 84 deputetë**

**Rama: Deri sot gjykata ka qenë faltore e korrupsionit**

*"Financat mund të na vënë kushte emergjence kombëtare"*

TIRANE

Kryeministri Edi Rama në një intervistë për emisionin e "7 pa 5", në VIZION+, tregoi për prioritetet e qeverisë së tij.

**Lidhur me çështjen e ndarjes së mandatit të deputetit... Kur do ndodhë kjo?**

Do të fillojë së shpejti. Është çështje procedurash dhe është çështje e një organizimi të brendshëm, për të bërë të mundur që të mos ndihet për asnjë moment në Kuvend, mungesa e votave, sepse po të shikoni dhe Kodin Zgjedhor, ka disa afate dhe ka disa procedura për zëvendësimin e një deputeti me një tjetër.

**A ndjeni një lloj presioni nga "senatorët" e PS...?**

E vërteta është që ata të cilët ju iu referohen si senatorë, janë pjesa më mbështetëse e ndryshimeve të ndodhura.

**Nuk keni frikë se pas këtyre muajve të parë të mjalitit do keni dhe shumë të pakënaqur në rreshtat e partisë e militantëve...?**

S'kam frikë nga asgjë, përveç se nga çfarë do të gjejmë përpara në

**"A mund të bëhet operacion në një sallë operacioni të mbushur me plehra?! Apo në radhë të parë duhet pastruar salla e operacionit dhe pastaj të fillojë operacioni?!"**

kuptimin e shifrave të të dhënave të ekonomisë e të financave, në kuptimin e të papriturave që mund të na ndodhin dhe mund të na vënë në kushte emergjencash kombëtare.

**Për të qenë më konkretë, cilat do të jenë sfidat e ekzekutivit "Rama" në këto 100 ditë të para, të paktën?**

Zgjimi i një shteti tërësisht të përgjurmur, me pjesë të tëra të trupit të tij që janë të paralizuar dhe me



Kryeministri Edi Rama

një pjesë shumë të madhe të trurit të vet që është jashtë funksionit.

**Një detyrë e rëndësishme e lënë nga Brukseli është dhënia fund e kulturës së pandëshkueshmërisë në Shqipëri. Do të kemi diçka konkrete në këto 100 ditë që kemi para?**

Ju e dini shumë mirë që kultura e pandëshkueshmërisë është një kulturë që i ka rrënjët sa tek një shtet, në tërësi, i kapur prej korrupsionit, tek një qeveri e paafte për të luftuar sëmundjen që e ushqen vet korrupsionin. Tek një prokurori e cila, deri më sot, nuk është treguar në lartësinë e duhur përballë korrupsionit dhe tek një gjykatë që, deri më sot, më shumë ka qenë faltore e korrupsionit sesa ndëshkimore për korrupsionin.

**Duke qëndruar sërish tek Brukseli, duket se filozofia juaj qeverisëse synon më shumë modernizimin sesa ndëshkimin...?**

Qeveria nuk është as prokurori, nuk është as gjykatë. Qeveria ka objektiv të vetin modernizimin dhe modernizimi në raport me korrupsionin, do të thotë ngushtim i hapësirave për korrupsionin. Por, sigurisht që qeveria, teksa modernizon, nuk mund të bashkëtojë me korrupsionin, përkundrazi, duhet që

**PRIORITETET**

"Mnaxhimi i territorit, menaxhimi i ujërave e sundimi i ligjit, prioritetet. Sigurisht që në rrugën e realizimit të programit, do ketë gjëra që do preken në fillim, do të ketë gjëra që do preken më vonë dhe tërësia e rezultateve do të mund të shihet vetëm në fund".

nuk do të thotë që për këtë duhet të na pyesni ne. Duhet të pyesni ata që vendosin që të ndërrojnë krahun, apo të votojnë për një ligj, ose një tjetër, që lidhet me vullnetin e shumicës.

**Kjo do të tregojë se ka negociata? Nard Ndoka do të kalojë me ju?**

Ju siguroj që s'kam pasur kohë të merrem me çfarë flitet e çfarë përfillet, sepse jua thashë, zgjohem në më.

**Do të kishit bërë sërish të njëjtat premtime, shëndetësi falas, legalizime falas?**

Premtimet e bëra, apo zotimet e marra, janë pjesë e një vizioni dhe bazohen në një program. Është vizioni për Shqipërinë që duam, për ky vizion nuk mund të kondicionohet nga gjendja financiare në një moment të caktuar. Gjendja financiare thjesht lëviz në kohë axhendën, por zotimet janë po ato.

**A ka kontakte me aleatët e tjerë, përpos LSI...?**

Duhet të pyesni ata. Unë kam qenë shumë i përqëndruar në këtë periudhë fare të parë për të sistemuar disa aspekte të mekanizmit qeverisës, që nuk kanë të bëjnë me marrëveshjen me aleatët. Për të gjitha çfarë jemi marrë vesh, do vazhdojmë të merremi vesh.

**18 deputetët e LSI, janë një mbështetje për ju apo është ajo çka ju keni paralajmëruar dikur, një rritje e LSI e zvogëlim i PS?**

Nuk shikoj asnjë zvogëlim të PS. Përkundrazi! Kemi marrë rezultatin më të mirë historik në këto zgjedhje. Ashtu sikundër, nuk shikoj një trupë deputetësh të ndarë në PS e në LSI.



**LAJME SHKURT**

**■ Kryeministri: Ja pse kemi shumë gra në qeverisje**  
Kryeministri Edi Rama ka shpjeguar pse ka shumë gra në qeverisje. "Besoj se në këto pika kyçe, që janë dhe pikat ku ndodhen gjëndrat më të mëdha tumorale të korrupsionit, është shumë e rëndësishme të ndërthurim profesionalizmin, që unë ju siguroj që të gjitha këto vajza e kanë, me luajalitetin ndaj misionit të marrë dhe me ambicien profesionale që po ashtu, të gjitha e kanë, sikundër edhe domosdoshmërinë që jo vetëm për vajzat, por edhe për djemtë, t'i jepet mundësi gjeneratës së re që të marrë në dorë përgjegjësi më të mëdha", ka qenë deklarata e djeshme e Ramës.

**■ PD, Vorpsi: Edi Rama nuk po mban premtimet elektorale**  
PD ka artikulluar akuzën në drejtim të Kryeministrit Rama se po u devijon premtimeve të bëra në fushatën elektorale për shëndetësi falas. Në një reagim pas takimit të Kryeministrit me drejtuesit dhe mjekët e QSUT, zëdhënësjja e selisë blu, Laura Vorpsi, tha se Rama nuk tha asgjë lidhur me taksën progresive që premtoi dhe shëndetësinë falas. "Kush shkon në spital, e ka një hall. Edi Rama shkoi sot në spital, dhe halli i tij i madh është se ka premtuar shëndetësi falas për të gjithë, dhe sa më shumë kalojnë ditët, aq më shumë del në dritë ky mashtim elektorat. Mashtimin e Ramës për shëndetësi falas, s'ka mjek që ta kurojë" tha Vorpsi.



## Bashkëshortja e Bumçit dorëhiqet nga detyra në MPJ

Ilda Zhulali, gruaja e Aldo Bumçit ka bërë një letër lamtumire për zyrën e saj, pasi ka dhënë dorëheqje nga Ministria e Jashtme, në të cilën është punësuar në kohën e socialistëve më 2001. "Po ju rrëmbej veç një moment, për t'ju njoftuar se unë po largohem nga Ministria e Punëve të Jashtme. Tetori i 2001 më solli këtu, tetori 2013 po më shpice diku gjetkë. Çdo

ditë, edhe sot, edhe nesër me mirënjohje falënderohem që m'u ofrua mundësia për të punuar në MPJ. Falënderohem që m'u besuan, posaçërisht, dy projekte që do të ishin çndrra e çdo diplomati, dhe që ndodhin veç një herë e askurrë më, ndjekja e procesit të pavarësimit të Kosovës dhe e liberalizimit të vizave me BE", shkruan Zhulali. Ajo e ka cilësuar

përvojë në diplomaci të mrekullueshme, ndërsa ka falënderuar të gjithë ata që e kanë ndihmuar dhe ndarë me ta gëzimet dhe shqetësimet e punës. "Ju siguroj se përherë dhe vërtetësisht jam përpjekur të jap më të mirën time, njerëzore aq sa është. Ju falënderoj dhe mirupafshim, shpejt...", thotë ajo. Duke vlerësuar një rikthim të shpejtë në diplomaci.

# Presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë: Qeveria të veprojë Pensionet, ushtarakët: Të shfuqizohet ligji i Berishës

Pogaçi: Përfitojnë 7500 ushtarakë. Pensionet janë ulur

## LAJMI

Presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë, Mehdi Pogaçi kërkon nga qeveria e re që të ndërmarrë hapin e parë të premtuar për zgjidhjen e çështjes së pensioneve, duke realizuar në këtë mënyrë jo vetëm kërkesën e tyre por dhe premtimin elektoral të PS.

## TIRANE

JAKIN MARENA



NË FOTO: Presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë, Mehdi Pogaçi

## Në fushatë



Rama: Do rishikohen pensionet ushtarake

Gjatë fushatës elektorale, kreu i PS Edi Rama tekta ka akuzuar qeverinë e Berishës se u ka mohuar të drejtat ushtarakëve, ka deklaruar se do të shfuqizojë aktin normativ që cënon të drejtat e tyre. "S'ka dyshim që ndër ato akte të pashembullta, barbarie, antikushetuese, antidemokratike, antinjerëzore, siç është edhe ky akt që ne do ta shfuqizojmë si akt i parë i respektit të qeverisë sonë ndaj njerëzve të zakonshëm të këtij vendi, padyshim do shfuqizojmë edhe aktin normativ që Salu në kundërshtim me Kushtetutën dhe në mungesë të plotë respekti për dinjitetin tuaj e miratoj. Do ta shfuqizojmë si shprehje e respektit tonë për të gjithë ju", tha Rama atë kohë.



NË FOTO: Edi Rama gjatë një takimi me ish-ushtarakët, gjatë fushatës elektorale

## Përkeqësimi

# Pensionet me aktin normativ mbi pagën neto dhe jo bruto

Para këtyre ndryshimeve, nenit 4, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 10142, thoshte se: "Paga referuese përbëhet nga paga bazë mujore për gradë, sipas viteve të shërbimit dhe shtesat mbi pagë, ose nga paga bazë mujore për funksion dhe shtesat, që përcaktohen e zbatohen për të njëjtën gradë apo funksion në datën e lindjes së të drejtës së një përfitimi. Për efekt të përcaktimit të përfitimit, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të qëndrimit në atë gradë apo funksion. Pagat referuese të njësuara dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese për të gjithë karrierën përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave". Me aktin normativ, tashmë, për efekt të llogaritjes së përfitimit, paga referuese neto është paga që rezulton pas zbritjes, nga paga referuese, të kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, plus tatimin mbi të ardhurat



Ish-ushtarakët gjatë një proteste

personale, plus kontributin suplementar, sipas këtij ligji, të cilat mbahen nga paga. Paga mesatare referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese sipas periudhave të qëndrimit në atë gradë apo funksion, duke ulur ndjeshëm pensionin suplementar.

studim, dhe ku do të arrihet në bazë respektimit të të gjitha ligjeve, statusit të ushtarakut, që nuk janë zbatuar nga qeveritë e mëparshme. Pra të shikohet mbi këtë bazë dhe duke bashkëpunuar shoqatën e ushtarakëve. Kuptohet që gjithçka duhet të fillojë

nga shfuqimi i akteve normative që kanë dëmtuar rëndë situatën e ushtarakëve.

**Cili mendoni se është hapi i parë që duhet të ndërmerret...?**

Hapi i parë, deri sa të shfu-

qizohet akti normativ, është të ndërpritet për llogaritjen e uljes së pensioneve mbi bazën e të ardhurave neto, dhe atyre që u është ulur të shkojë në nivelin e mëparshëm, pasi është antillogar dhe antikushetues. Është edhe kundër të gjitha akteve

të Helsinkit, pasi çenohet e drejta themelore e njeriut. Pra të ndërpritet pagesa e ulur e ushtarakëve në rezervë dhe të hiqet debiti që Insituti i Sigurimeve Shoqërore pa të drejtë u ka vendosur atyre. Në bazë të aktit ISSH bën llogaritjen e

## PËRFITUESIT

"Përfitojnë afërsisht 7500 ushtarakë në rezervë. Ata që janë shpallur debitorë dhe që duhet të kthejnë paratë e marra në bazë të ligjit të vjetër, janë afër 3 mijë veta. Nëse vijon me këtë ritëm që të penalizohen atëherë ata rriten më shumë".

pensioneve, ua ul atë me një masë të konsiderueshme, por duke qënë se akti normativ ka nisur aplikimin një vit më parë, këtë diferencë ua mbajnë si debit atyre që e kanë marrë përpara se të hynte në fuqi Akti Normativ.

**Keni pasur deri më tani ndonjë kontakt me kryeministrin....?**

Akoma nuk kemi pasur ndonjë kontakt me kryeministrin Edi Rama, jemi në traktativa dhe bisedime dhe presim së shpejti që të fillojmë diskutimet në mënyrë të detajuar, në mënyrë që të shfuqizohet akti normativ dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme ligji për pensionet suplementare për ushtarakët në rezervë.

**Sa ushtarakë përfitojnë nga ky shfuqizim i aktit normativ?**

Përfitojnë afërsisht 7500 ushtarakë në rezervë. Ata që janë shpallur debitorë dhe që duhet të kthejnë paratë e marra në bazë të ligjit të vjetër, janë afër 3 mijë veta. Nëse vijon me këtë ritëm që të penalizohen, atëherë ky kontigjent rriten më shumë.

**Si e mendoni se mund të realizohet duke ruajtur këto balanca kërkesa juaj për shfuqizimin e këtij ligji dhe përfitimet që rrjedhin prej tij?**  
Kjo kërkon që të bëhet një





**Rama, me gjithë  
zv/ministrat e  
kabinetit qeveritar**



**K**ryeministri Edi Rama ka mbledhur në kryeministri të 23 zëvendësministrat, me të cilët ka diskutuar në lidhje me detyrën e vështirë që kanë marrë përsipër në realizimin e detyrave për qeverisjen e re. Tashmë të

kthyer në një moto të tij ai i motivimit të të gjithë drejtuesve të rinj, për të realizuar një për një të gjitha pikat e programit të qeverisjes, kreu i qeverisë nuk ka munguar që në këtë takim të evidentojë detyrën e vështirë që del përpara

numrave dy të qeverisë për ringritjen e vendit, por dhe besimin që ka tek ata për realizimin me sukses të detyrës. Njëherësh Rama ka postuar në Facebook një foto me gjithë zv/ministrat e kabinetit të tij, të emëruar tri ditë më parë.



**Reagimi**

**Bregu: Unë çanta dhe makina aq të shtrenjta?! Gënjeshtër injorantësh**

■ ■ ■ TIRANE

**I**sh-Ministrja e Integritimit Integritimit Majlinda Bregu ka reaguar ndaj akuzave për përdorim makinash luksoze. "Para pak ditësh një e përditshme publikoi në faqe të parë, një lajm me foto për makinën që kam blerë. Duke mirëkuptuar dhe ndjenjën e pakënaqësisë që ky lajm mund të ngjallë tek ndokush që ditën e nis me një hall të madh mbi kokë, si papunësia apo mundësia për të plotësuar nevojat e përditshme të familjes, po ju them dy fjalë: Më vjen keq pikërisht për manipulimin që një e përditshme merr përsipër t'ju bëjë emocioneve të këtyre njerëzve. Shumë miq të mi sa herë që publikohen gënjeshtër injorantësh e dashakeqësisht për çanta me çmime



Majlinda Bregu

stratosferike, apo këpuçë me majë e pa majë, me lëkurë derri apo ngjyra jo të moralshme, deri tek këto shifra të denja për një apartament për makinën më thonë: lëri të flasin, mos reago se nuk e sqaron dot atë që thotë gazeta".

Mund të jetë dhe kështu. Mund të kenë plotësisht të drejtë", deklaroi Bregu. Ajo nënvizon se nuk fton askënd të vrsë mendjen të gjejë arsënyen e këtyre lajmeve. Sipas saj, të gjithë këto lajme jepen për arsënye se kryeministri kërkon të manipulojë opinionin për të hequr vëmendjen nga bëmat e kësaj qeverie. "Po ju ftoj të gjithëve ju që s'dini se ç'çantë kam në dorë, por i besoni gazetës se bën 20 mijë euro, nuk dini se e kujt viti është makina që kam blerë, sa km ka bërë, çfarë opsionesh ka, elementë që çmimin e largojnë më shumë se 10 herë nga vlera që gazetat jua servirin për t'ju lënduar të kërkonin informacion për të vertetur sa, ku, si është e verteta. Unë e bëj këtë çdo vit zyrtarisht, në përgjigje të ligjit e jo të pallavrave që duan të shesin gazetat", shkruan Bregu në facebook.

**Vendimi i fundit: Nënoficerë të armatosur vetëm gjatë shërbimit**

**“Çarmatoset” Garda, jo më pistoletën në shtëpi  
Vetëm oficerët e Gardës s'preken nga urdhëri**

■ ■ ■ TIRANE

**N**ënoficerët e Gardës së Republikës nuk do të marrin më armën në shtëpi për ta mbajtur atë dhe jashtë kushteve të shërbimit. Përmes një urdhëri të prerë të dhënë vetëm dy ditë më parë, kreu i Gardës së Republikës Gramoz Sako ka kërkuar që të gjithë nënoficerët e Gardës së Republikës pas përfundimit të shërbimit, do të dorëzojnë në repartin përkatës armët e tyre për të udhëtuar në drejtim të shtëpisë dhe në kohën e lirë i paarmatosur. Mësohet se një urdhër i tillë prek një numër shumë të madh punonjësish të Gardës, pasi pjesa më e madhe e tyre janë nënoficerë. Ndërkohë që urdhëri i nxjerrë për Gardën e Republikës nuk prek oficerët, të cilët ashtu sikurse më parë do të kenë të drejtën e mbajtjes së armës dhe pas përfundimit të shërbimit ditor sipas detyrës. Mësohet se urdhëri i Komandantit të komanduar të Gardës së Republikës, Gramoz Sato për dorëzimin e armëve të shërbimit për nënoficerët në momentin që përfundojnë atë, ka nisur të zbatohet që ditën e djeshme. Teksa nënoficerët gardistë kanë lënë në repart armët e tyre pas përfundimit të punës, për t'i marrë sërish ditën që do të kenë shërbim sipas grafikut. Urdhëri i dhënë për dorëzimin e armës nga ana e nënoficerëve të Gardës



në fund të orarit të shërbimit në repartin respektiv është në kuadër të përpjekjeve për të reformuar Gardën por dhe për të parandaluar përdorimin e armëve të shtetit në shërbim të punës jashtë orarit nëpër ambiente private, resorte turistike, kazino dhe lokale të

tjera luksi. Pasi në këtë rast vihet në dilemë vetë institucioni i rëndësishëm i shtetit, që ka për detyrë ruajtjen e personaliteteve dhe të objekteve të rëndësishme së veçantë. Nga ana tjetër, me armët që kanë pasur në shtëpi nënoficerët e Gardës së Republikës, në jo

**PRECEDENTI I USHTRISE**

Vite më parë, në kohën e qeverisjes së të djathtës në mandatin 1992-1997, u mor vendimi që të gjithë oficerët madhorë ose jo të Forcave të Armatosura të Ushtrisë shqiptare të dorëzonin armët pas përfundimit të shërbimit dhe orarit zyrtar në dikaster.

pak raste janë kryer vrasje nga pakujdesia nga familjarët e vetë ushtarakëve, por dhe janë kryer vrasje dhe përdorur në konflikte të ndryshme, duke përbërë një rrezik të madh për qytetarët dhe zonat në të cilën jetojnë këta nënoficerë të Gardës. Reforma në Gardë ka filluar disa ditë më parë teksa ministri i Brendshëm Sajmir Tahiri ka thënë se fillon procesi i reformës më themelore në këtë institucion, ndoshta më i rëndësishmi në 85 vjetët e ekzistencës së këtij institucioni. Sipas tij, Garda e Republikës nuk do të ekzistojë më si e tillë dhe brenda 100 ditëve, do ketë përfunduar procesi i

reformimit dhe modernizimit, për t'i dhënë jetë Drejtorisë së Ruajtjes së Personaliteteve dhe Objekteve të Rëndësishme së Veçantë, e cila nuk do të varet më nga Ministri i Brendshëm siç ishte deri më sot Garda e Republikës, por do të jetë në zinxhirin e kompetencës dhe përgjegjësisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Duke paralajmëruar dhe një zingjir reformash në funksion të kësaj reforme, deklarimi i së cilës ka sjellë dhe reagimin opozitës, përmes liderit të saj historik Sali Berisha por dhe ish-ministrit të Brendshëm Flamur Noka se po shuhet historia e këtij institucioni.

**LAJME SHKURT**

■ **Deputeti socialist, Peza: Të reformohet sa më shpejt RTSH**  
Deputeti i PS, gazetari Alfred Peza kërkon një reformim të shpejtë. Me një shënim në profilin e tij në rrjetin social Facebook, Peza shkruan se, "një nga institucionet që kërkojnë reformim të shpejtë e të thellë është RTSH". Sipas tij, "Radio Televizioni Shqiptar, i duhet rikthyer pranonit të vërtetë: Publikut shqiptar. Përvëqse një institucion i politizuar dhe jo profesional, aktualisht RTSH-ja ka një moment paligjshmërie, për shkak të skadimit të mandateve të anëtarëve të KD, të Bordit Administrativ e të Drejtorit të Përgjithshëm", thotë Peza.

■ **Ish-kryeministri: Nuk reformohet PD duke sajuar armiq**  
Ish-kryeministri Aleksandër Meksi për mediat shprehet se nuk reformohet PD. "S'është hera e parë që dështrimin Berisha nuk e analizon, por e kalon duke "reformuar PD" me të tij, duke sajuar armiq. Kjo ndodhi në 1997 me grupin e 27-tëve". Këtë e bëri me dorëheqjen e tij formale duke zgjedhur (emëruar ai) me "një anëtar-një votë" kryetarin, një regull demokratik i mohuar vazhdimisht me kryeneqësi nga ai. Kjo s'reformon PD, përkundrazi, sepse nuk e hap, por vetëm e mbyll me të tij, duke mos e rikthyer në shtëpinë e gjithë demokrateve", tha Meksi për mediat.



## POLITIKE

## Polonia ndihmë Shqipërisë për integrimin evropian

Mes Shqipërisë dhe Polonisë do të ketë shkëmbim eksperiencash për sa i përket integritetit të vendit tonë në Bashkimin Evropian. Polonia si një vend që ka kaluar nëpër këtë proces, do t'i japë ndihmë Shqipërisë për të kryer reformat e nevojshme për të marrë statusin e vendit kandidat. Kjo lajm është bërë i ditur nga njoftimi i ministrit të Integritetit pas takimit që pati dje ministri Klajda Gjoshja me

ambasadorin e Polonisë në Tiranë, Marek Jezorski. "Ministria Gjoshja e falenderoi Ambasadorin për mbështetjen që Polonia i ka dhënë Shqipërisë për Integrimin në Bashkimin Evropian si dhe për marrëdhëniet e mira dypalëshe. Ministria vlerësoi se shkëmbimi i eksperiencës mes dy vendeve do të jetë inkurajues për Shqipërinë, kjo dhe për faktin se Polonia ka kaluar nëpër të njëjtin proces", shkruhet në deklaratën

e ardhur nga ministria e Integritetit. Nga ana tjetër, Ambasadori Jezorski, e uroi Ministrin Gjoshja për detyrën e re, si dhe për sukseset të mëtejshme të Shqipërisë në procesin e Integritetit Evropian. Në kuadër të bashkëpunimit midis dy vendeve, Ambasadori e informoi Ministrin Gjoshja lidhur me vizitën e ardhshme të Zv/Ministrit të Jashtëm të Polonisë në muajin nëntor në Tiranë.

## Ish-ministri i PD në A1Report: Bojkotimi do vazhdojë

# Ruli: Administrata tani duhet çpolitizuar

"Vendimet e qeverisë, bufori arrogante"

## LAJMI

I ftuar në A1 Report ish-ministri i Bujqësisë, Genc Ruli ka folur rreth qëndrimit bojkotues në Kuvend të opozitës. Ai ka kërkuar konsensus, ndërkohë që ka akuzar Ramën se kur ishte kryetar bashkie ka patur një administratë politike.

## TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Ish-ministri i Bujqësisë, Genc Ruli i ftuar në emisionin "5 pyetje nga Baramo" në televizionin "A1 Report" ka theksuar se Partia Demokratike do të vijojë që të mbajë qëndrimin bojkotues në Kuvend deri sa mes palëve të arrihet një konsensus. "Bojkotim për një veprim konkret, për shtyrjen me akt normativ të statusit të ligjit të nëpunësit civil. Ka qenë ligj, që është miratuar në formë konsensuale. Për rëndësinë që ka duhet patjetër që për çdo ndryshim, që do të bëhet, do kërkojmë me zë demokratik që nëpërmjet bojkotit të arrijmë konsensusin për ndryshimet që do të bëjmë këtij ligji", u shpreh Ruli. Sipas deputetit demokrat, është domosdoshmëri që shteti shqiptar të krijojë administratën civile profesionale jopartiake, pasi ky vihet si kusht për integrimin nga BE. "Çdo parti është në presionin politik të forcës që vjen: erdhe në pushtet të kam dhënë votën, do vend pune. A do dalim nga ky rreth vicioz, që nuk mbaron dhe do krijojmë një administratë të apolitizuar? Nëse në maj kishim në mend këtë gjë, që do kalojmë në një orbitë të re, se dhe koha tingëllon për këtë gjë, pse duhet të ishte kështu? U premtua nga Rama, që s'do preket administrata", tha Ruli. Në lidhje me reagimin e Brukselit, se duhet kohë për ligjin, Ruli u përgjigj se "unë kuptoj një stërlodhje që ka Brukseli, që me shqiptarët po bëhet ekzagjerisht sfilite. Shqipëria i ka plotësuar kushtet që në 2011. Pretekstet për një qëndrim atipik vetëm nga opozita e bëri Shqipërinë të rriji mbrrapa. Opozitat e vendeve të tjera edhe më agresive, por të integrimi i kapërcenin dallimet".

## SPASTRIMET

Gjatë fjalës së tij, ish-ministri i Bujqësisë ka folur edhe në lidhje me spastrimet e administratës që është bërë

## Administrata

Të gjithë morën statusin se dolën të aftë. Nuk ka asnjë njeri të marrë pa konkurs, edhe pse brenda konkursit kishte hapësira subjektivistë. Plus shkurtuam numrin e administratës deri në 85 mijë vetë. Nuk kaluam në fshirje me fshesë.

**NË FOTO:**  
Ish-ministri  
Genc Ruli  
mbrëmë në  
A1REPORT



kur në pushtet ka ardhur e djathta. "Në 98 dy breza demokratë u zhdukën nga puna dhe s'kishte të bënte me meritokracinë", është ankuar Ruli. Ndër të tjera ai theksoi se "administrata

e bashkisë së Ramës ishte e mirëfilltë politike. Qenë trupa politike të fortësh në qendra votimi. Ai ka situar se shifra 37 mijë është shifër e Klosit dhe e njëanëshme, në administratën e qeverisë Berisha

nuk është respektuar 100% apolitizimi, por ka përparim të ndjeshëm", u shpreh Ruli.

## VENDIMET E QEVERISË

"Kemi vendimet e para dhe

## Fotoja e Nishanit

"Nga një anë thotë Shqipëria në moment të vështirë, e ketej veprimet e para në vend t'i japë problematikës, i ka me fotografinë e Nishanit, me në duhet shqiptonja e Skënderbeut apo Muzakës. Sindroma e vitit zero është shumë shqetësuese. Paranoja e Ramës është për të thënë historia fillon me mua, dhe për të thënë se kryeministër si unë s'ka pasur kurrë"

veprimet e para: butafori arrogant që në historinë e Shqipërisë nuk më ka qel-luar të shoh një frymëzim të tillë. Ramës do i bëhet qejfi, se këtë do, unë jam ndryshe nga gjithë kryeministrit. Merrret me Nishanin. As Ismail Qemali nuk do donte. Ai nuk është thjesht rilindasi. Ai s'po do të njohë shtetin shqiptar dhe do që historia të fillojë me atë. Prek simbollet", u shpreh Ruli në lidhje me vendimet e para që ka marrë qeveria



## Kur ka qenë emergjencë civile në qershor që ke shpenzuar karburant?

Deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe ka reaguar dje në Facebook për shpërdorimin e 1 milion litra naftë nga ministri i Mbrojtjes Arben Imami, në muajin qershor, muaj

që përkon edhe me fushatën zgjedhore. Braçe ngre pyetjen ndaj Imami, se në çfarë rasti emergjent e ka përdorur 1 milion litra karburant

NGA ERJON BRAÇE

"Arben Imami ka pranuar që: Ka blere naftë, 1 milion litra naftë në mes të qershorit për ministrinë e mbrojtjes!!  
Por, ish ministri i Mbrojtjes thote se e ka përdorur ate per nevoja te emergjences komunitare!!!!!!  
Tani dua tu pyes;  
Keni degjuar ju per ndonje emergjence civilene muajt qershor, korrik, gusht?  
Asgje ka ndodhur!!  
Tani duhet hetim;  
kur kane ndodhur emergjencat-  
ne

cmuaj, date, te cilit karakteri jane, ku kane ndodhur-ne cilin qark, rreth, komune, sa eshte shpenzuar per to!!  
Ky eshte shperdorim i paster, vcanerisht kur merr vesh se:  
1 milion litra naftë jane shperdorur keshu, nderkohe gadishmeria e strukturave te mbrojtjes eshte cenuar rende, shume rende. (po e le me kaq per te mos treguar turpin)  
Dhe nuk eshte vetem kjo.  
Jane 1 milion dollare te tjera te bera rrush e kumbulla, tamam tamam

reklama per ministrin e mbrojtjes mu ne mes te qershorit!!  
Eshte njesoj si rasti Ksera dhe provat per kete jane te qarta!!  
Imami eshte ministri qe duhet te pergjigjet deri me ne!!  
Boll u vodh ky vend!!", ka shkruar Erjon Braçe në Facebook, në lidhje me blerjen e karburantit gjatë kohës së fushatës elektorale me paratë e taksapaguesve shqiptarë.

Postuar në Facebook  
në orën 18:30, 7 tetor 2013

## LAJME SHKURT



### Naço: Në nëntor hapat e para kundër korrupsionit

Ministri i Drejtësisë Haxhinasto tha se deri në muajin nëntor, kur pritet të mbahet edhe Konferenca Kombëtare Kundër Korrupsionit, Drejtësia do të ketë hedhur hapat e para kundër korrupsionit. Ky ka qenë premtimi që Naço e ka bërë gjatë takimit me ambasadorin e Spanjës teksa flitej për projektet Eurallius në Shqipëri. "Aktualisht, Ministria e Drejtësisë po harton një Projekt-Draft për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, në mënyrë që të kemi një task-forcë të drejtuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Aktualisht, është një grup i vogël gjyqtarësh që merrem me hetimin e krimeve, por mendoj që ata duhet të trajnohen me lidhje të kontrollit edhe puna e tyre. Deri në nëntor, kur pritet të mbahet Konferenca Kombëtare Kundër Korrupsionit, ne do t'i kemi hedhur hapat e para kundër korrupsionit në drejtësi."- theksoi Ministri Naço.

**Spanja: Qeveria u ndryshua, por nuk duhet ndërprerje**  
Qeveria ka ndryshuar, por shteti është po ai dhe nuk duhet të ketë ndërprerje. Kështu është shprehur ambasadori i Spanjës në një takim që ka patur dje me ministrin e Drejtësisë, Nasip Naço për projektet ekzistuese me Eurallius dhe Lamp. Në një takim në Ministrinë e Drejtësisë ambasadori Rafael Perez tha: "Vazhdimësia është e rëndësishme për ne, prandaj mbështetemi tek vullneti juaj për të vazhduar projektin Eurallius. Qeveria ka ndryshuar, por shteti është po ai dhe nuk duhet të ketë ndërprerje. Kjo gjithashtu, është një nga pikat në të cilat këmbëngul edhe BE. Sikurse ju e dini, ne bashkëpunojmë me vendin tuaj edhe përmes projektit LAMP, që ka të bëjë me kadastrën. Konkretisht, në Lamp, Spanja mbulon 10 % të financimit të projektit, i cili pritet të përfundojë në fund të 2014, ashtu siç e kërkon edhe Banka Botërore".





## Obama letër Berishës: Duhet opozitë efektive dhe konstruktive

Ish-kryeministri, Sali Berisha, publikoi dje një letër të presidentit amerikan Barak Obama, ku ndër të tjera ai i kërkon atij një opozitë konstruktive. “Ka qenë nder dhe kënaqësi që kam punuar me Ju gjatë mandatit Tuaj si Kryeministër i Shqipërisë. Shqipëria është një aleat dhe mik i shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ne gëzojmë një partneritet të fortë në shumë fusha.

Si Kryeministër, Ju keni ndihmuar në thellimin dhe forcimin e lidhjeve midis dy vendeve tona. Unë dua t’Ju falenderoj për mbështetjen Tuaj ndaj përpjekjeve tona në Afganistan dhe Siri si dhe për punën Tuaj në ruajtjen e stabilitetit në Ballkan. Do të doja gjithashtu të rikonfirmoj mirënjohjen time për bashkëpunimin e qeverisë suaj në lehtësimin e transferimit të të burgosurve të

Guantanamo Bay dhe banorëve të Hurriya Camp. Këto janë çështje të rëndësishme dhe ne e vlerësojmë mbështetjen e fortë të Shqipërisë. Shqipëria ka nevojë për një opozitë efektive dhe konstruktive që fokusohet në zhvillimet e vendit dhe punon me qeverinë e re për të prodhuar rezultate të prekshme për popullin shqiptar,” thuhet në letër.

PS merr një tjetër pikë doganore, vendos ish-deputetin

# Konomi në krye të doganës së Durrësit

Dërgohet në prokurori dosja e korrupsionit

## LAJMI

Edison Konomi, ish-deputeti i partisë Socialiste është emëruar dje në krye të doganës së Durrësit. Lajmi është bërë i ditur nga drejtoresha e Doganave, Elisa Spiropali

## TIRANE

Është zgjedhur emri i ish-deputetit të Partisë Socialiste për të drejtuar doganën në Durrës. Edison Konomi do të jetë zyrtarisht drejtor i Doganave në qytetin bregdetar. Elisa Spiropali, drejtoresha e Doganave ka zyrtarizuar dje pikërisht këtë emër. Ish-deputeti i Durrësit ka kaluar filtrin e drejtoreshës Spiropali për të qenë në drej-

tues i kësaj dogane. Përveç kësaj, Spiropali tha se ka pasur një valë pezullimesh dhe emërimesh të reja në dogana. “Ka pas dia pezullime dhe emërime të reja për arsye të rezultateve të dobëta. Ka pasur rënie dramatike të të ardhurave. Dëmi që i është shkaktuar shtetit sh-



Edison Konomi

qiptar është i lartë. Ka nevojë emergjente që këto të ardhura të rriten. Të gjithë personat që janë emëruar kanë kaluar në një proces filtrimi nga drejtorja e Përgjithme. Ka patur pezullime në degën e Kapshitiçës, Riansit, Kakavisë”, është shprehur Spiropali. E ftuar në një emision tel-

eviziv, ajo i ka dhënë fund ngjyrosjes së doganave me idenë e bërjes së parave. Ajo ka pohuar se “në doganën shqiptare nuk do të bëhet më lek”, duke kumbngulur kështu se do të jetë gjatë gjithë kohës në zbatim të ligjit. “Është perceptimi se në doganë mund t’i vësh gjoba biznosit, mund

ta kërcënosh biznezin etj. Ka doganierë apo punonjës të administratës doganore që kanë punuar me vite dhe janë njerëz të ndershëm. Ka qenë një vend ku mund të bëhej me lek. Më doganën shqiptare nuk do bëhet më lekë. Kushdo që do kapet, duke i shkaktuar dëm shtetit shqiptar, do dënohet sipas ligjit”, ka thënë Spiropali duke dhënë edhe anët e errët se si funksionojnë doganat në vendin tonë. Gjatë intervistës ajo ka treguar këmbngulje se asnjë biznes nuk do të favorizohet. “Biznesi do të kryej detyrimet e tij para shtetit”, ka thënë drejtoresha e re e Doganave. Spiropali ka bërë me dije se i ka dërguar Prokurorisë një dosje voluminoze për të gjitha shkeljet që janë bërë në dogane, sidomos në tre muajt e fundit para zgjedhjeve.

## Microsoft lajmëron drejtuesin e saj të ri në Shqipëri

Agim Bekaj emërohet si Drejtor i Microsoft në Shqipëri

Tiranë, 7 tetor 2013 – Sot Microsoft lajmëron ndryshime në drejtimin e zyrës së saj në Shqipëri, e cila funksionon në ndihmë të biznesit, në një kohë kur kompania po transformohet drejt ofrimit të paisjeve dhe shërbimeve. Agim Bekaj është emëruar si Drejtori i Microsoft në Shqipëri dhe fillon në këtë pozicion në datën 4 nëntor 2013. Në këtë rol Agimi zëvendëson Drejtorin e mëparshëm Arsen Kurti, i cili e la kompaninë në datën 30 shtator për të zhvilluar më tej karrierën e tij në industrinë e Tik në Shqipëri.

Robert Trnovc, Drejtor i Përgjithshëm për Microsoft në Slloveni dhe Shqipëri komenton: “Kam kënaqësinë të prezantoj Agim Bekaj si Drejtor të Microsoft në Shqipëri. Agimi e merr këtë pozicion në një kohë shumë të rëndësishme kur Microsoft po transformohet me shpejtësi në një kompani paisjesh dhe shërbimesh. Kam besim se Agimi, me një eksperiencë mbi 30 vjetecare në këtë fushë dhe me njohuri shumë të thella sa i përket përfitimit dhe

përdorimit të teknologjisë në industri të ndryshme do të kontribuojë fuqishëm në biznesin e Microsoft në Shqipëri.”

Përpara pranimit të këtij pozicioni Agimi, prej vitit 2006 ka punuar si Menaxher për Zhvillimin e Biznesit për Microsoft në Kosovë. Në funksione të mëparshme ai ka drejtuar departamentin e Tik pranë Krye Ministrisë të Kosovës në periudhën 2005-2006. Prej vitit 1985 e deri në vitin 2005 Agimi ka punuar

në kompani të ndryshme private dhe publike. Agimi krijoi edhe kompaninë e parë të dedikuar në zhvillimin e aplikacioneve softuerike. Ai ka eksperiencë me vlerë në punën që ka kryer në fushën e TIK me misionet diplomatike të Kosovës dhe ato të Komunitetit Europian. Agimi është diplomuar në Inxhinieri Elektrike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike – Departamenti i Informatikës, Universiteti i Sarajevës, Bosnjë dhe Hercegovinë, si edhe ka përfunduar studimet MSI (Shkenca e Sistemeve të Informacionit) në Universitetin, Vaxjo, Suedi.

Agim Bekaj, i cili do të marrë këtë rol prej datës 4 nëntor, komenton: “Ndjehem i nderuar dhe plot me energji nga kjo mundësi që më jepet për të drejtuar ekipin e Microsoft në Shqipëri. Ekipi i Microsoft në Shqipëri ka individë shumë të suksesshëm dhe shumë të talentuar. Së bashku do të vazhdojmë të sjellim përfitime teknologjike për bizneset

në Shqipëri, organizatat publike dhe individët duke bashkëpunuar më partnerët tanë, qeverinë dhe shoqërinë shqiptare.”

**Mbi Microsoft në Shqipëri:**

Microsoft filloi veprimtarinë në Shqipëri prej Korrikut të vitit 2008 dhe ka vazhduar të rrisë numrin e kompanive inovative brenda rrjetit të Partnerëve Microsoft. Microsoft Albania ka punuar në bashkëpunim me Qeverinë, bizneset, organizatat jo-qeveritare (OJQ-të) dhe individë duke ndihmuar përshtetimin e rritjes ekonomike, përfundimin e rinisë dhe edukimin e inovacionit- të sigurojë që Shqipëria merr shpërblimet sociale dhe ekonomike të TIK.

**Contacts for media:**

Robert Trnovc, Drejtor i Përgjithshëm i Microsoft Slovenia & Albania

Zana Jakeviciene, Drejtuese e PR per CEE, email: v-zajake@microsoft.com



## Sinan Tafaj kandidat për anëtar në Gjykatën e Lartë



Kreu i Këshillit Kombëtar të Personave me Afërsi të Kufizuar, Sinan Tafaj është një nga kandidatët që kanë shprehur dëshirën për të qenë kandidat për në Gjykatën e Lartë. Pas ndryshimit të ligjit për Gjykatën e Lartë, Presidenti i Republikës kishte lënë afat deri javën e

ardhshme për të dorëzuar dosjen e dokumentacionit për personat që pretendojnë të fitojnë një vend, në këtë institucion. Pas emërimit të tre anëtarëve të rinj, pak kohë më parë, pritet t'i shtohen këtyrë institucioni edhe dy anëtarë të tjerë. Njëri nga personat që ka dorëzuar dosjen e dokumenteve

dhe pretendon të zgjidhet si njëri prej këtyre anëtarëve, është edhe Sinan Tafaj, avokat me eksperiencë në fushën e të drejtave të njeriut. Ndërkohë që sot kreu i shtetit pritet që të zhvillojë takime me krerët e grupeve parlamentare në lidhje me propozimin e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Vazhdon bojkoti ndaj ndryshimit të ligjit për Nëpunësin Civil

# Akti normativ të enjten në Kuvend pa opozitën

Xhafa: Apel për konsensus. MPJ do monitorojë terroristët

## LAJME SHKURT

**■ Bushati pret homologun lituanез**  
Ministri i Jashtëm lituanез, Linas Linkevicius pritet që të vizitojë vendin tonë në kuadër të takimeve të rëndësishme që ka me drejtuesit më të lartë në vend. Këtë lajm e ka bërë të ditur vetë ministri i Jashtëm i vendit tonë, Ditmir Bushati. "Nesër (sot) mirpres në Tiranë homologun lituanез Link-evicius, vendi i të cilit mban presidencën e radhës të BE. Europa: Familja që i përkasim!", shkruan ministri i Punëve të Jashtme, Bushati. Ky status i tij është komentuar edhe nga deputeti socialist, Erjon Braçe, i cili shkruan shkurt "Kthim në Evropë domethënë."

**■ KQZ miraton sot kryetarët e KZAZ**  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen që do të mbajë sot pritet që të miratojë një sërë vendimesh të rëndësishme që kanë të bëjnë me zgjedhjet e pjesshme në Korçë. Bëhet fjalë për emërimin e kryetarit të KZAZ nëpërmjet zgjedhjet në Korçë, si dhe kryetarin e KZAZ në komunën Karburnarë. "Miratimi i modeleve të dokumenteve që do të përdoren nga grupi i numërimit dhe komisioni i zonës së administrimit zgjedhor për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme të datës 03.11.2013. Miratimi i modelit të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar që do zhvillohen më datë 03.11.2013", thuhet në rendin e diskutimeve.

## LAJMI

Komisionet parlamentare miratuan dje vetëm me votat e mazhorancës një sërë projektligjesh. Opozita vijon bojkotin e saj. Sot pritet që Komisioni i Ligjeve të shqyrtojë aktin normativ të qeverisë për nëpunësin civil.

## TIRANE

ARTEMISA HOXHA



Komisioni Parlamentar i Ligjeve

e mazhorancës. Të enjten Partia Demokratike ankimoi vendimin qeverisës e për të vonuar zbatimin e ligjit, në Gjykatën Kushtetuese. Në kushtet e mungesës së deputeteve të opozitës, mazhoranca pritet të miratojë e vetme, aktin normative më të kundërshtuar deri më tani të qeverisë Rama.

## LIGJET

Komisioni i Ligjeve kaloi vetëm me votat e mazhorancës projektligjin për "Masat Kundër Financimit të Terrorizmit", nisëm kjo që i jep kompetenca Ministrisë së Jashtme që të vërë e para në lëvizje Këshillin e Ministrave porsa i takon vendimit për të përfshirë në listën e person-

## NDRYSHIMI

Ministri i Punëve të Jashtme, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të Këshillit të Sigurimit, i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen në listën e personave të shpallur, duke njoftuar njëkohësisht organet përgjegjëse, ato të zbatimit të ligjit, shërbimet informative dhe ministrin e Financave.

ave terroristë. Sipas relatores, Ermonela Felaj ky projektligj sjell një sërë ndryshimesh në krahasim me nismën që ka qenë propozuar nga e djathta. "Ndryshimi i parë që sjell ky projekt është dhënia rol e ministrit të Punëve të Jashtme ku do të jetë institucioni që do të vërë i pari në lëvizje Këshillin e Ministrave

porsa i takon vendimit për të përfshirë në listën e personave terroristë. Në të njëjtën kohë ai do të vërë në djeji organet të tjera ligjzbatuese, duke filluar që nga prokurori i Përgjithshëm, ministri i Financave, Shërbimi Informativ etj. Ajo çfarë ndryshon nga ligji i vjetër është që më parë ka qenë Drejtoria e Pastrimit të Parave që nëpërmjet një personi të saj shqyrtonte portalin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përsa i takon listës së personave të shpallur terroristë. Në momentin kur ky portal së bashku me të dhënat bëhet zyrtar, me projektligjin e ri futet në lojë ministri i Jashtëm për arsyes se në Këshillin e Sigurimit, Ministria e Jashtme ka një zyrë përfaqësimi pranë OKB-së, e cila ka mundësi ta marrë listën e personave terroristë dhe për ata që nxirren jashtë liste në momentin më të parë", u shpreh deputetja e PS në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ligjeve.

## Largimi

# Demokratët e Korçës shkojnë drejt FRD

Akuza PD-së, Shehaj: Parti e kthyer në merkato, mendon vetëm për interesa vetiake

## TIRANE

Opozita përveç largimit të deputetëve nga grupi i saj po përballlet dhe me largimin e të anëtarësuarve nga partitë e saj. Bëhet fjalë për largimin e një numri të madh të anëtarësuarish nga Partia Demokratike drejt Frymës së Re Demokratike. Një grup i madh të rinjsh nga qyteti i Korçës, anëtarë dhe simpatizantë të Partisë Demokratike të kësaj Dege, në prag të zgjedhjeve elektorale të 3 Nëntorit për Kreun e Bashkisë së Korçës, kanë vendosur të dorëzojnë kartelat e anëtarësisë së këtij subjekti politik për tu bashkuar me partinë tjetër të djathtë që kandidon në këto zgjedhje Frymën e re Demokratike. Anëtar i Komisionit të Burimeve



njerëzore në PD Dega, Genci Shehaj, e ka komentuar largimin e tij si dhe të rinjëve të PD si faj të PD që sipas tij është kthyer në një parti për interesa vetjake të personave të caktuar. "PD Korçë nuk përfaqëson më asnjë ideal veçse interesa vetjake të disa personave që mbanjnë poste politike brenda saj. Zgjedhjet lokale janë kthyer nga një sfidë për ta qeverisur me mirë bashkinë e Korçës në një arenë intrigash për të sabotuar kandidatët që pretendojnë kreun e PD të kësaj Dege, zgjedhjet për të cilin do të mbahen pas disa muajsh. Një tjetër arsye që më shtyn drejt largimit nga ky subjekt politik është hyrja në zgjedhjet lokale pa bërë analizën e tyre të mëparshme. Kjo tregon një mungesë të thellë përgjegjësi nga ana e drejtuesve të Partisë", u shpreh Shehaj.

Ai u shpreh se ka qenë iniciator i kësaj lëvizjeje pasi Partia Demokratike të Dege Korçë është uzurpuar në nivel të ndryshme nga persona të papërgjegjshëm, persona që për të marrë kreun e PD janë të gatshëm të bashkojnë votat e tyre me Partinë Socialiste. "Partia Demokratike e kësaj Dege tashmë është kthyer në një merkato ku idealistët largohen çdo ditë e më shumë, për tu zëvendësuar nga mercenarë të cilët jo vetëm nuk i lidh asgjë me Partinë Demokratike të kësaj Dege, por deri dje kanë punuar kundra saj. Frika për garën për kreun e Degës ka detyruar shumë prej drejtuesve të kësaj Dege që të mos marrin masa kundra anëtarëve të kryesisë që në zgjedhjet e 23 qershorit dolën hapur në podiumet e partive të tjera të kualicionit", tha Shehaj.





**Kompanitë e propagandës u komanduan nga PD**

Ministry of Communication” dhe “Media Print” janë dy kompani të njëjtit pronar, e cila është në fakt zyra e shtypit e PD. Socialistët, ende në opozitë, deklaruan se pronari kryesor i këtyre dy kompanive ishte dizajneri i fushatave të PD-së dhe ortak pa letra i Flamur Nokës në këtë veprimtari, Elvis Themeli. Kjo kompani ka fituar deri në fund të mandatit të Berishës

miliona dollarë me organizime eventesh për PD, që iu faturoheshin ministrive. Kështu ajo ka marrë rreth 500 mijë dollarë për organizimin e mitingut të 1 Majit kur u shfaq Çiljeta apo mitingun e shkurtit 2011. Shpenzimet për këto evente në vend të Partisë Demokratike i ka paguar Ministria e Integritimit, ajo e Kulturës apo ministria e Punës, si dhe Këshilli i Ministrave, edhe

pse ato ishin festa të PD-së. Megjithëse KLSH kërkoi dëmshpërblim për shtetin shqiptar nga ajo, ministria e Integritimit i dha 170.000 dollarë fonde për realizime dhe transmetime spotesh. Pra nga njëra anë dënohej nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ndërsa chej edhe në organin e Akuzës, ndërsa nga ana tjetër qeveria vazhdoi ta ushqejë atë me fonde.

# Ministry of Communication e Elvis Themelit morën paratë e 1 Majit Agjencia e reklamave e PD fitoi tenderin e skandalit

Pas arrestimeve në Ministrinë e Punës zbardhet skema

Akuza në 2012

Shalsi: Ja abuzimi i Berishës me reklamata

Në vitin 2012 deputeti socialist Eduard Shalsi tha se 2/3-at e fondeve të Ministrisë së Transporteve, Drejtorisë së Rrugëve dhe ministrisë së Mbrojtjes në qeverinë Berisha kanë marrë vetëm 4 media. Ndërsa 17 të tjera kanë përfituar vetëm 1/3-tën. Ai ka akuzuar duke qenë në opozitë praktikën e ndjekur nga ana e institucioneve qendrore të Berishës, të përqendrimin të fondeve publike në pak subjekte. Ministria e Olddashit doli se kishte financuar direkt Rilindjen Demokratike me 500.000 USD. Ndërkohë, ministria e Mbrojtjes u kishte dhënë 100% të fondeve për publikime Frangajve. Gjithashtu, edhe dikasteri i Brendshëm u kishte dhënë miliona euro, po prapë Frangave. “Kjo qeveri e zhytur në korrupsion na paska zhvatur edhe para publike për të financuar Partinë Demokratike, mediat dhe kompanitë pranë pushtetit”.

LAJMI

Korrupsioni në ministrinë e Punës, të drejtuar nga Spiro Ksera, duke vënë dorë mbi fondet e buxhetit destinuar për festën e 1 Majit, është kryer nga një kompani ndërmjetëse, kompania e Elvis Themelit, të afërt me krerët e Partisë Demokratike

TIRANE  
GENC KONDI


Kontrolli i Shtetit

Dëmi i llogaritur ndaj shtetit është 66 mijë euro

Më datë 21.05.2012 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është depozituar kallzimi penal nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në ngarkim të punonjëseve të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Sipas kallzimit, gjatë organizimit të aktivitetit për festën e 1 Majit 2010 është vepruar në kundërshtim me ligjin dhe në praktikën për organizimin e këtij aktiviteti ka mungesa të shumta për dokumentimin e aktivitetit, duke vlerësuar një dëm ekonomik për arkën e shtetit në vlerën 9.237.863 lekë ose 66 mijë euro.

realizonin edhe vjedhjen e fondeve publike. Sipas Prokurorisë, u është kërkuar informacion tre televizioneve kombëtare, ku, sipas ofertës së paraqitur nga subjekti fitues MC do të transmetohej spoti televiziv për festën e 1 Majit, por ka rezultuar se MC ka pajtuar një kompani tjetër PLATEA për një shërbim të

tillë. Në akt-akuzë rezulton e provuar që subjekti MC ka kontraktuar me tre televizione dhe subjektin Platea që në datat 27.04.2010 dhe 28.04.2010, por konkurrimi rezultoi të jetë bërë krejtësisht fiktiv, pasi, nga dokumentacioni, rezultoi që oferta e subjektit fitues të jetë protokolluar në ministri më



Faksimile e ekstraktit të regjistrimit në OKR të kompanisë Ministry of Communication

datë 29.04.2010 dhe kontrata që e ka shpallur fitues është lidhur më datë 30.04.2010, çka të bind se subjekti fitues është paracaktuar dhe nuk ka patur konkurrencë fare.

Ministri

## Akuza do të thërrasë në pyetje Spiro Kserën

Nga hetimet e Prokurorisë rezulton se ish-ministri kishte dijeni për çfarë ka ndodhur

TIRANE



Spiro Ksera

Pas arrestimit të dy ish-zyrtarëve të dikasterit të Punës e Çështjeve Sociale dhe shpalljes në kërkim të dy ish-funksionarëve të tjerë të Kserës, nga hetimet e Prokurorisë në dokumentin e siguruar nga “A1Report” rezultoi se ish-ministri Ksera kishte dijeni për çfarë ka ndodhur. Sekretari i përgjithshëm, Murat Mehmeti më dt.30 prill i kishte dorëzuar një raport ministrit për procedurat e ndjekura për tenderin dhe po në atë datë, në emër të ministrit, firmoste kontratën me një nga tri kompanitë. Burime nga organi i akuzës për “A1Report” bëjnë

me dije se hetimet janë ende të hapura, ku dhe vetë ministri Ksera mund të thirret për t’u marrë në pyetje nga grupi hetimor. Për të katër drejtuesit e Ministrisë së Punës, të akuzuar për korrupsion, Gjykata e Tiranës ka lënë sot në fuqi masat “arrest me burg”. Dy prej të arrestuarve dolën para gjykatës: ish – shefi i Financës Ilir Ibrahimimi dhe ish-Sekretari i Përgjithshëm Besnik Dema. Ibrahimimi nuk pranoi të flasë, ndërkohë që avokati kërkoi ndryshimin e masës së sigurisë, ç’ka u kundërshtua nga prokurori. Ndërsa Dema kërkoi të lirohet, duke pretenduar se procedurat e tenderit janë në zbatim të ligjit dhe rregullores. Dy të akuzuarit e tjerë janë

shpallur në kërkim. Ata janë: Kleves Bitro, ish-Drejtori i Kabinetit dhe Murat Mehmeti. Sipas prokurorisë, zyrtarët e Ministrisë akuzohen për “falsifikim të dokumenteve” pasi kanë paracaktuar një tender prej 20 milionë lekësh për një sport televiziv, i cili nuk është realizuar asnjëherë. Praktika e dhënies së një grupi të vogël subjektshë paratë e buxhetit është parë edhe raste të tjera. Pesë kompani me lidhje shumë afër pushtetit garuan edhe për të për fituar tenderin i milionë euro të 3 koncerteve festive të datës 28 nëntor 2012 në Tiranë. Ishin të njëjtat kompani që vazhdimisht ndanë fondet qeveritare për organizimin e eventeve të ndryshme.

AKT-AKUZA

Por, nëpërmjet këtij subjekti, qeveritarët e Berishës

# Reforma

**MEDIKAMENTET** kanë skaduar gjatë 2012-ës, pasi ishin për sëmundje shumë të rralla. Sipas socialistëve, tashmë do të ndryshojë skema e blerjes së tyre

## QSUT, 240 mijë euro barna të skaduara

Prisheet skaneri, Rama: Fund kësaj skeme

### LAJMI

Miliona lekë që jep buxheti i shtetit çdo vit për qendrën universitare spitalore "Nënë Tereza" zhduken pa përfunduar tek shërbimi i pacientit. Kryeministri Edi Rama, në një takim të zhvilluar dje me shefat e shërbimeve të QSUT-së, ka deklaruar se do të ndryshojë tërësisht mënyra se si administrohet kjo qendër spitalore.

### TIRANE

ESMERALDA KETA

A buzimet në qendrën Universitare Spitalore "Nënë Tereza" janë nga më habitshmet. Kështu viti 2012 është mbyllur me plot 240 mijë euro barna të skaduara, pasi nuk kanë mundur të përdoren. Kjo jo se nuk ka pacientë, por sepse janë medikamente për sëmundje shumë të rralla. Por, sipas skemës së re të qeverisjes Socialiste, duke filluar që nga janari i këtij viti që po vjen, kur hyn në fuqi edhe buxheti i ri, nuk do të ketë më tenderime të kësaj natyre. Kryeministri Edi Rama, ministri i Shëndetësisë, Ilir Beqja, dhe drejtoresha e QSUT-së, Ogerta Manastirliu, kanë shpalosur dje përpara shefat të shërbimeve, skemën se si do të transformojnë QSUT-në, e cila është qendra më e rëndësishme spitalore në vend, duke zhdukur korupsionin, keqmenaxhimin dhe duke bërë që çdo qindrakë e dalje nga buxheti i shtetit të shkojë në shërbim të pacientit. Kështu sipas përfaqësuesve më të lartë të qeverisjes socialiste, QSUT ka nevojë për një ndërthyrje të thellë dhe kjo ndërthyrje do të fillojë me ndryshimin e skemës së blerjes së medikamenteve, do të vendoset një çmim tavan për ta, do të ngrihet këshilli kombëtar i shëndetësisë ku do të diskutohen strategjitë e zhvillimit të këtij sektori, si dhe do të nisë menjëherë shlyerja e borxhit prej 22 milionë dollarë që ky spital aktualisht në mënyrë që në vitin buxhetor 2014 ai të hyjë me zero borxhe. Në fjalën e tij kryeministri Rama nuk i ka kursyer kritikën për sistemin aktual të shëndetësisë, por sipas tij, në ndodhemi në një moment kur kemi më shumë nevojë për të vërtetën e hidhur se sa për gënjeshtërta mashtruese. "Aktualisht QSUT është një nga gjëndrat më të këqija tumorale të të gjitha shërbimeve që ofrohen në vendin tonë. Mund të themi se këtu shteti ka rënë, dhe nëse ky spital mbahet në këmbë kjo është meritë e një grupi mjekësh që janë 'jetimët' e Hipokratit. Të gjithë këta



NË FOTO: Kryeministri Edi Rama në takim me krerët e QSUT

mjekë kishin mundësi që ta bënin karrierën e tyre në spitalet më të mira të botës, por zgjedhën të vijnë në Shqipëri për ta na bindur të gjithëve se mjekësia nuk është vetëm aparatura dhe teknologji, por është mbi të gjitha mision dhe vizion. Dhe ne i garantojmë se në këto reforma që do të ndërrojmë do të na kenë për krah dhe duam ti kemi në krah. Aktualisht jemi në një gjendje, kur vetëm 2012 është mbyllur me

240 mijë euro barna të skaduara, të premtën është prishur edhe skaneri i pediatrisë. Kemi 6 milionë euro aparatura nga të cilat 3,3 milionë euro nuk janë në gjendje pune, dhe 2,7 milionë euro janë prishur. Nuk mund të vazhdohet më kështu. Unë ju them se ky spital nuk ka nevojë për më shumë lekë, por ka nevojë për sistem. Ne do të ndryshojmë mënyrën se si do të tenderohen medikamentet. Po ashtu unë ju them se do të

- PREMTIMET E QEVERISE SE RE**
- Do të krijohet Këshilli Kombëtar i Shëndetësisë
  - Do të vendosen kritere performace për çdo individ dhe për çdo shërbim
  - Do të shlyhet borxhi prej 22 mln dollarë
  - Do të ndryshojë skema se si do të furnizohet me medikamente
  - Do të vendoset çmim tavan për barnat
  - Do të hiqet TVSH-ja prej 10 %
  - Do të merret mendimi i shefave të shërbimit për çdo mjek të ri të punësuar
  - Do të ndryshojë skema e mbulimit të sigurimeve shëndetësore
  - Spitalet do të kenë më shumë autonomi
  - Do të hapet një forum për të diskutuar për ekzistencën apo jo të universitetit të Mjekësisë



### LAJME SHKURT

**Fondi shqiptaro-amerikan, mbështetje për bizneset e Tiranës**  
Kryebashkiaku Basha është takuar dje me anëtarët e bordit të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve dhe kryetarin e tij, Michael Granoff. Shtrirja e bashkëpunimit në fusha me interes të veçantë për Bashkinë e Tiranës, si nxitja e zhvillimit ekonomik dhe mundësitë për punësim kanë qenë në qendër të bisedës. Kryetari i bordit të Fondit Shqiptaro-Amerikan ka theksuar se përmes partneritetit shumë të mirë që ekziston me Fondin e qeverisjes në nivel qëndror dhe lokal janë hedhur hapa të rëndësishëm, në përmirësimin e jetesë për mjaft qytetarë shqiptarë.

**Politekniku, akreditimi i universiteteve s'mund të rikthehet**  
Akreditimi është një proces që nuk mund të këhelet nga e para. Ai duhet të vazhdojë nga një agjensi e huaj, e njëjta për të gjitha universitetet publike dhe private. Kështu mendon Jorgaq Kaçani, rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës. "Nuk ka për tu rikthyer sepse ky është proces i pakthyeshëm, sepse duhet vlerësim i brendshëm. Cilado që të jetë procedurë ky vlerësim i brendshëm do të bëhet në të gjitha fazat qoftë tani qoftë edhe më mbrrapa. Ajo që kam ngritur që në fillim është që të jetë një agjensi e huaj dhe të jetë njëjtë për të gjitha universitetet e larta në Shqipëri. Të jetë një tregues i njëjtë dhe ky do përcaktojë pastaj se cilat universitete i plotësojnë standartet për të qenë të akredituar dhe cilat nuk i plotësojnë - thotë Kaçani.

### Aksioni

## Prishen kioskat dhe lokalet në Qytetin Studenti

### TIRANE

Pas shumë vitesh funksionimi, kioskat dhe lokalet në Qytetin Studenti janë prishur. Urdhri i lëshuar rreth dy javë më parë nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, Arben Ahmetaj, për anulimin e kontratave të kioskave që kryenin aktivitet ekonomik në këtë zonë, po zbatohet me përpikëri. Duket që pre e këtij urdhri nuk janë vetëm kioskat e vogla, por edhe shtesat e lokaleve të ndryshme, të cilat kishin zënë hapësira të konisderueshme. Pavarësisht mosaprovimit të pronarëve, duket se ky Gjatë ditës së djeshme, fadromat janë ende në punë e sipër për të spastruar gjithë zonën



dhe për t'i kthyer këto ambiente që deri më tani kanë ofruar kafe dhe argëtim, në hapësira të gjelbërta. Ky urdhër ka shkaktuar dëm ekonomik për shumë

aktivitete në Qytetin Studenti, që përpos dëmit material, konsiderohen me fat që funksionojnë në këtë zonë për shkak të frekuentimit të lartë të studentëve. Ndërsa nuk dihet ende nëse do të ketë kompensim për pronarët që i kanë të lidhura kontratat e aktiviteteve ekonomike me Drejtorinë e Qytetit Studenti. Në fakt, një vit më parë, gazeta "Shqiptarja.com" ka denoncuar publikisht dhënien e disa ambeinteve me qera në zonën e qytetit studentit, për t'u kthyer në lokale, por askush nuk ndërmorri asnjë masë pezullimi. Aksioni ka nisur së pari në QSUT, kur tashmë janë prishur thuasje të gjithë lokalet me leje që zhvillonin aktivitetin e tyre tregtar në këtë zonë spitalore.





Foto e marrë nga profili "Facebook" i Edi Ramës, duke inspektuar prishjen e lokaleve në QSUT, së bashku me ministrin Ilir Beqja

## PRO DHE KUNDER PROPOZIMIT

# Mjekësia, universiteti është në pikëpyetje

'Forum për të vendosur nëse do të ekzistojë'

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

Ekzistenca e universitetit të Mjekësisë, i krijuar me një vendim të qeverisë Berisha në janar të këtij viti, do të vendoset nëpërmjet një forumi, mes ekspertëve më të mirë të shëndetësisë. Kryeministri i vendit, Edi Rama, gjatë takimit të djeshëm me shefat e QSUT-së, ka deklaruar se brenda muajit tetor, ministri i Shëndetësisë do të mblodhë ekspertët më të mirë të kësaj fushe, ku do të diskutojnë për fatin e këtij universiteti. "Do të mblidhemi për të diskutuar mbi ekzistencën e universitetit të Mjekësisë. Pasi duhet të jemi të sigurt që ai nuk mund të



Jera Kruja

funksionojë më si një shtojë politike, ashtu siç u hap. Nëse vendosim që ky universitet do të funksionojë, atëherë duhet të përcaktojmë modalitetet si si duhet të rritet dhe fuqizohet, por kështu siç është, ai nuk mund të funksionojë", - ka deklaruar Edi Rama.

Dekani i Mjekësisë, Bajram

## DILEMA

Fakulteti i Mjekësisë, i ka kërkuar që në vitin 2007, Ministrisë së Arsimit që të shkëputet nga Universiteti i Tiranës, për shkak të konflikteve që kishte me rektorin Dhori Kule, dhe të krijohet universiteti i Mjekësisë.

Hysa, i cili prej kohësh po përplasat me rektorin e universitetit të Mjekësisë, Jera Kruja, dhe që ka kërkuar që ky universitet të mbyllet, nuk e ka fshehur entuziazimin për këtë propozim të Ramës edhe në sallën ku po zhvillohej takimi. "Ky projekt është i dëshuar që në fillim dhe uni-

versiteti i Mjekësisë, e ka nisur rrugëtimin e tij me shumë borxhe. Aktualisht jemi në një fazë ku fondet tona dhe të pagave të pedagogëve janë përdorur për universitetin. Ai dështoi që në fillim dhe nuk mund të vazhdojë më tej", - ka deklaruar dekani i Mjekësisë, Bajram Hysa. Ndërkohë që vetë rektorja e Mjekësisë, Jera Kruja, ka dëgjuar me qetësi propozimin e Ramës për institucionin arsimor që ajo drejton, jo e zgjedhur nga vota e kolegëve dhe studentëve, siç ndodh në të gjitha universitetet publike, por e emëruar me anë të një VKM-je, nuk ka preferuar të shprehet për këtë vendim. Ndonëse gazeta u përpoq të komunikonte me të për këtë çështje, ajo nuk pranoi të flasë fare në lidhje me propozimin e Ramës.

## SHENDETESI FALAS

Kryeministri Rama ka deklaruar se do të ndryshojë edhe skema e financimit të shërbimeve shëndetësore. Sipas tij Shqipëria ka dëhstuar me skemën aktuale të sigurimeve shëndetësore, ndaj nuk mund të vazhdohet më. Ndaj sipas tij e vetmja rrugë është ajo e mbulimit shëndetësor funksional



## MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONAVE PUBLIKE  
SHPALL PËR SHITJE OBJEKTIN E MËPOSHTËM :



Në bazë të VKM Nr. 428 datë 09.06.2010, i ndryshuar Kap.III, pika 2, gërma "b"

N/R	Emërtimi i Objektivit	Vendodhja	Vlera fillestare e shitjes	Vlera	Vlera totale	Sip gjithsej	Sip nën	Vlera e
			(M Kryes.+ VI. Mj.Xh) (në lekë)	Mjete Xhiro (në lekë)	e objektit (në lekë)	e objektit m <sup>2</sup>	objekt m <sup>2</sup>	truallit (në lekë)
1	<b>Në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Tiranë</b>							
a	Repartit i Përpunimit të Sojës	Tiranë	26 591 925	0	26 591 925	1 360	475	65 241 920

ISH PRONARËT E TRUALLIT TË INTERESUAR PËR TË BLERË OBJEKTIN DUHET TË PARAQESIN NË MINISTRIËN E FINANCIVE, NË DREJTORINË E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONAVE PUBLIKE, TIRANË BRENDË DATËS 20.10.2013 DOKUMENTAT SI MË POSHTË:

1. Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit të regjistruar në protokollin e Ministrisë së Financave.

2. Garancinë bankare (apo mandat pagesë) në origjinal që vërteton ngurtësimin prej 20% të vlerës fillestare vetëm për objektin.

Ngurtësimi do bëhet në çdo Bankë të nivelit të dytë të çdo rrethi në llogaritë respektive të hapur për Ministrinë e Financave, Tiranë

(DASHPP) detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

Ngurtësimi do të bëhet pasi të jetë tërhequr nga Ministria e Financave, (DASHPP) ose Degët e Thesarit në rrethe,

Faturën për Arkëtim e plotësuar dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave të shoqëruar me planvendosje të pronës apo çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në ZVRPP shoqëruar dhe me hartën treguese të pronës që përcakton se ai është pronari i tokës dhe marrëveshje të dokumentuar midis pronarëve.

4. Deklaratë notoriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parblerjes për objektin në proces privatizimi të deklarojnë se që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nuk kanë përfituar kompesim apo asnjë nga format e parashikuara me ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

5. Dokumentin e identifikimit ( pasaportë biometrike ose kartën e identitetit), Dëshminë e Trashëgimisë, prokurën e posaçme të përfaqësimit etj.

6. Brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit për kalim pronësie, ish-pronari i truallit është i detyruar të bëjë pagesën për vlerën e mbetur të 80 % të objektit me letra me vlerë dhe bono privatizimi, në të kundërt vlera që përfaqëson pagesën prej 20 % në lek CASH nuk i kthehet.

**Shënim:** Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit subjektin e shpronësuar Hysen dhe Ibrahim KAZAZI.

Afati i publikimit fillon në datën 20.09.2013 dhe mbaron në datën 20.10.2013

# University of New York Tirana

*Educating Tomorrow's Leaders!*



## Real American & European Education leading to the authentic Degrees of the Partner Universities

### ● BACHELOR's (PROFESSIONAL MASTER's)

**Economics & Business:** Finance, Business Administration, Management, Marketing, Economics, Accounting

**Computing:** Computer Science, Information Systems, Computer Networking Infrastructure Engineering

**Humanities & Social Sciences:** Political Science & Int'l Relations, Law, Communication & Journalism, English Language & Literature, Psychology

### ● MASTER's (MSc)

LL.M. (Master of Law) in International & Commercial Law, M.A. in International Affairs, MSc in Computer Science, MSc in Finance & Accounting

### ● MBAs (MSc)

General, Management, Banking, Marketing, Human Resource Management, Management of Information Systems

### ● Ph.D

**Ph.D in Business Administration** with concentration in: Economics, Finance, Accounting, Management, Marketing, International Business

**Ph.D in Computer Science** with concentration in: Computer Science, Management Information System

**Ph.D in Humanities & Social Sciences** with concentration in: Law, Political Science / Int'l Relations, Psychology, Education



**HERZING**  
UNIVERSITY

Partner Universities

University of New York Tirana hap PROGRAME TE REJA NE GJUHEN SHQIPE

Bachelor në Administrim Biznesi, Bachelor në Financë  
& Bachelor në Sisteme të Informacionit

**Admissions Office:** Rr. Medar Shtylla (ish Komuna Parisit)

Tel: + 355 4 2441330, Fax: + 355 4 2441329

e-Mail: [admissions@unyt.edu.al](mailto:admissions@unyt.edu.al), website: [www.unyt.edu.al](http://www.unyt.edu.al)



**UNIVERSITY OF  
NEW YORK TIRANA**





EMBASSY OF THE UNITED STATES  
AMBASADA E SH.B.A.

# LOTARIA AMERIKANE

## TREGOHUNI TË MENÇUR PARA DHE GJATË APLIKIMIT!

Para aplikimit, lexoni rregullat në: <http://tirana.usembassy.gov/dv.html>

### Kujdes!

- ★ Sigurohuni që arsimit tuaj kualifikohet!
- ★ Nuk ka asnjë pagesë për t'u regjistruar.
- ★ Ju mund ta kryeni vetë aplikimin tuaj.
- ★ Aplikoni vetëm një herë!
- ★ Përfshini gjithë pjesëtarët e familjes në aplikim.

Regjistrohuni në: [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov)  
Ruajeni numrin tuaj të konfirmimit!

**Ju urojmë fat!**



**CA**

# BIENVENUE!

**Përfitoni shumë duke paguar asgjë!**

Ofertë për mikpritjen e klientëve të rinj biznese, me këto kushte për 6 muaj:

- Pa komision hapje llogarie
- Asnjë komision mirëmbajtjeje deri në dy llogari
- Paguani çdo faturë utilitare
- Taksa apo sigurime shoqërore pa asnjë komision
- Asnjë komision regjistrimi në platformën e-banking
- Mund të merrni një kuti sigurie pa paguar qera (kjo ofertë është e vlefshme deri në ezaurimin e këtyre kutive).

[www.credit-agricole.al](http://www.credit-agricole.al)

**CA CRÉDIT AGRICOLE**



# Akt-akuza

**PROKURORIA** Nga tërësia e veprimeve hetimore, ka rezultuar se, nëse do të ishte prezent në sallën e operacionit medikamenti farmaceutik Dentrolen jeta e fëmijës me mundësinë më të madhe do të shpëtohej

# Vdekja e 11-vjeçarit ja shkeljet e mjekëve

## Prokuroria: 2 mjekët irlandezë harrojnë ilaçet



NË FOTO: Denis Alimadhi

### LAJMI

Prokuroria dërgon në gjykatë kërkesën për gjykim ndaj dy mjekëve irlandezë, Gerhald Fahy dhe Kevin Clarkson, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Mjekimit të pakujdesshëm" me pasojë vdekjen e 11 vjeçarit Denis Alimadhi, i cili po i nënshtrohet një operacioni estetik në sy. Ja akt-akuza e prokurorisë

### TIRANE

JONIDA ALIU

prokuroria deklaroi se mjekët, kanë vepruar me pakujdesi duke mos i dhënë mjekimin e nevojshëm në kohë, gjë që ka shkaktuar edhe vdekjen.

### PROCEDIMI PENAL

Prokuroria kujton që "me datën 08.11.2012 është njoftuar Komisarati i Policisë nr.4 Tiranë se në morgun e IMLigjore Tiranë ka shkuar nga Spitali Francez Tiranë në gjendje pajetë fëmija D.A dtl 2001, i cili ishte i shtruar më parë në këtë spital për një ndërhyrje kirurgjikale, estetike, të syve. Viktima ishte planizuar po më këtë datë për një ndërhyrje në sy nga grupi i mjekëve irlandez, konkretisht të pandehurit kirurgju okulist Gerald FAHY dhe mjeku anestezist Kevin CLARKSON. D.A vuanë nga sëmundja e lindur Ptoza (rënia) palpebrale e kapakëve të syve të sipërm (të të dy syve) dhe ka hyrë në operacion në gjendje të mirë shëndetësore (...). Është formuar grupi operacional i përbërë nga dy të pandehurit, stafi mbështetës dhe ndërhyrja ka filluar normalisht në orët e paradites së datës 08.11.2012. Gjatë operacionit pacienti D.A ka pasur komplikacione të menjëhershme duke u shoqëruar me temperaturë të lartë 45, shkaktuar si reaksion nga narkoza. Në këtë operacion të udhëhequr nga të pandehurit kanë qenë në rolin e vëzhguesit edhe mjekët shqiptar të pavijonit të okulistikës për qëllime trajnimit dhe marrje experience, por jo në përbërje të grupit që kryenin direkt operacionin. Gjendja e pacientit D.A u rëndua së tepërmi pavarësisht ndërhyrjeve dhe mjekimit të rastit që u bë për ti shpëtuar jetën. Fëmija D.A gjeti vdekjen në sallën e operacionit pas disa orësh nga fillimi i operacionit. Sipas ekspertizave mjeko-ligjore duheshin marr që më parë të gjitha masat për shmangien e një reaksioni nga narkoza, siç ndodhi në rastin konkret, ku sëmundja e hipertermisë të Denisit është shfaqur në prag të përfundimit të operacionit. "Shqiptarja.com"

**"Për këtë rast dy të pandehurit duhet të mbajnë përgjegjësi penale sipas ligjit penal shqiptar për këtë pasojë të pakthyeshme humbjen e jetës së një fëmije 11 vjeçar"**

### KERKESA

Gjykimin e çështjes penale Nr 5705 të vitit 2012 me të pandehur shtetasit Irlandez Kevin CLARKSON dhe Gerald (Gerry) Thomas FAHY të akuzuar secili për kryerjen e veprës penale të "Mjekimit të pakujdesshëm", (me pasojë vdekjen e fëmijës 11 vjeçar D.A) të kryer në bashkëpunim me njëri tjetrin veprë penale e parashikuar dhe e dënueshme nga nenet 96/1 dhe 25 i K.Penal.

pasojë të rëndë) apo sigurimin më parë të medikamenteve specifike për mjekimin e saj. Sipas prokurorisë dy mjekët irlandez "me veprimet e tyre neglizhente dhe mosvepruese, duke vepruar me pakujdesi nuk i kanë dhënë mjekimin e duhur në kohë sipas protokolleve mjekësore pacientit në fjalë, duke i shkaktuar atij vdekjen e menjëhershme. Ishte detyra e tyre të parashikonin çdo lloj komplikacioni dhe të garantonin ekzistencën e mjekimit të duhur për zgjidhje në çdo rast para se të hynin në sallën e operacionit. Për këtë rast të dy të pandehurit duhet të mbajnë përgjegjësi penale sipas ligjit penal shqiptar për këtë pasojë të pakthyeshme, humbjen e jetës së një fëmije 11 vjeçar, atë të D.A në sallën e operacionit i cili hyri më datë 08.11.2012 për një ndërhyrje estetike në sy dhe doli prej saj i pajetë.

### LAJME SHKURT

**Arrestohet nënkomisari i Pogradecit për korrupsion**  
Agustin Cinari, me detyrë specialist i hetimit dhe parandalimit të krimt në Komisaratin e Pogradecit është arrestuar nën akuzën për korrupsion. Cinari është kapur mbrëmjen e djeshme në flagrancë në një operacion të organizuar nga SHKB, i cili i kishte kërkuar lekë një personi, duke i premtuar atij se do t'i mbyllte një çështje që kishte të hapur dhe pikërisht në momentin e shkëmbit të parave është vënë në pranga.

**Tepelenë, dyshohet se dhunuar të mosharit, bien në pranga**  
Dy vëllezër janë arrestuar nga policia për dhunimin e dy vëllezërve të mosharit në fshatin Arrëz e Madhe. Policia e Gjykostrës ka bërë të ditur se, ka arrestuar Emiliano dhe Dorian Shehun, 18 dhe 26 vjeç. Edhe vëllezërit janë nga i njëjti fshat me dy vëllezërit Sali dhe Hito Hoxha. B

**Vjen në Shqipëri për tu martuar, merret peng malazezi**  
Një ngjarje e pazakontë është regjistruar në një fshat të Lezhës, ku një shtetas malazez pasi vjen në Shqipëri për tu martuar merret peng. Sipas burimeve të policisë dyshohet se malazezi është marrë peng nga njerëz të afërt të nuses. Policia shton më tej se pengun u lirua tre ditë më parë, gjatë një operacioni të uniformave blu të Lezhës. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka marrë në hetim ngjarjen, për të zbardhur plotësisht shkaqet.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MJEDISIT**

---

**FTESA PËR OFERTË**

Ministria e Mjedisit së Shqipërisë (në vijim e referuar si **Autoriteti Kontraktues**) fton investitorë të interesuar vendas dhe të huaj të marrin pjesë në procedurat konkurruese përzgjedhëse për përdorimin me koncesion të burimit ujor "Sasaj", Bunec, Sarande.

Vendndodhja dhe menyra e terheqjes se dokumentave te procedures konkurruese do te behet ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 268, date 18.04.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të Procedurave Konkurruese të dhënies së Koncesionit" dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 269, date 18.04.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar.

Ofertuesit e interesuar mund të njihem me dokumentat standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Të dhënat e kontaktit: Tel.: 3554 2250223;**  
Personi i kontaktit: Alqi Bllako  
E-mail: [Alqi.Bllako@moe.gov.al](mailto:Alqi.Bllako@moe.gov.al)

Ofertat do të ngarkohen (upload) në adresën zyrtare të APP-së: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) jo më vonë se data 28.10.2013  
Çdo ofertë e ngarkuar pas këtij afati nuk do të pranohet

Prokuroria e Tiranës ka çuar në gjykatë kërkesën për gjykim ndaj dy mjekëve irlandezë, të cilët asistuan në operacionin e 11 vjeçarit Denis Alimadhi, i cili humbi jetën teksa po i nënshtrohet një operacioni estetik në sy. Ekspertiza mjeko-ligjore doli në përfundimin se duheshin marrë që më parë të gjitha masat për shmangien e një reaksioni nga narkoza, siç ndodhi në rastin konkret, ku sëmundja e hipertermisë të Denisit është shfaqur në prag të përfundimit të operacionit. "Shqiptarja.com"

Operacionin. Gjendja e pacientit D.A u rëndua së tepërmi pavarësisht ndërhyrjeve dhe mjekimit të rastit që u bë për ti shpëtuar jetën. Fëmija D.A gjeti vdekjen në sallën e operacionit pas disa orësh nga fillimi i operacionit. Sipas ekspertizave mjeko-ligjore duheshin marr që më parë të gjitha masat për shmangien e një reaksioni nga narkoza, siç ndodhi në rastin konkret, ku sëmundja e hipertermisë të Denisit është shfaqur në prag të përfundimit të operacionit. "Shqiptarja.com"



**Grabiten në furgonin e bankës 3 mln lekë të Spitalit Amerikan**

Grabiten 3 milionë lekë në filialin e Spitalit Amerikan në lagjen Laprakë të Tiranës. Ngjarja ka ndodhur ditën e djeshme rreth orës 16:45, teksa thesi me para po transportohej nga financa e spitalit drejt makinës së sigurisë së policisë private "Octopus", me targë TR 0731M, në hyrje të Spitalit Amerikan, filialit që gjendet brenda mjediseve të Spitalit Ushtrarak në Laprakë,

e më pas do të niseshin drejt një banke të nivelit të dytë, një ritual i përditshëm ky. Mungesa e shumës prej 3 milionë lekë të reja është konstatuar teksa transportonin thesin drejt makinës. Sipas përfaqësuesve të Spitalit Amerikan, paratë në çastin e grabitjes kanë qenë në dorëzimin e punonjësve të Raiffaisen Bank. E konfirmim këtë lajm Stela Mako, shefe e marrëdhënieve me publikun pranë Spitalit

Amerikan. Pasi është konstatuar mungesa e parave janë informuar uniformat blu. Nga burimet e policisë dyshohet se kemi të bëjmë me vjedhje nga persona të brendshëm në spital. Për këtë qëllim janë duke u pyetur katër vetë të stafit të financës, pikërisht persona që kishin dëgjim për shumën dhe administronin sasinë e parave. Gjithashtu pritet që kamerat e sigurisë do të ndihmojnë hetimet.

**DURRES Vdekja në stol e të moshuarës 87-vjeçare**

# Bashkia: Strehim Llazar Qendros

*"Ai dhe tezja refuzuan propozimet tona"*

**LAJMI**

Një ditë pas vdekjes së 87 vjeçares Sofie Qendro, Bashkia e Durrësit ka strehuar në azilin e të moshuarve, nipin e saj Llazar Qendro. Në një intervistë për "Shqiptarja.com" Llazar tregon vuajtjet e tyre që prej 21 gushtit kur i nxorën nga banesa

**DURRES**  
**ARTUR KORRIKU**

Pas vdekjes së 87 vjeçares Sofie Qendro në qytetin e Durrësit duket se ka më tepër ndjeshmëri lidhur me strehimin e nipit të saj Llazi. Teze e nip u nxorën në fund të gushtit nga banesa e tyre pasi ajo ju kthehej pronarit. Që nga ajo ditë ata i kaluan netët si mundën dhe në më të shumtën e rasteve në qiejll të hapur në lulishten që ndodhet në qendrën e qytetit. Të shtunën në mbrëmje e moshuara ndërroi jetë për shkak të sëmundjeve të akumuluar si dhe për pasojë të qëndrimit jashtë sidomos gjatë netëve të fundit kur moti pësoi ulje të ndjeshme. Pas vdekjes bashkia ka vendosur që ti japë strehim Llazar Qendros në një garsonierë tek banesat sociale të cilat pritet që të ndahen në muajin nëntor.



Sofie Qendro

Ndërsa në lulishte kanë kaluar 1 muaj e gjysmë. "Varrimin e tezes e bëri bashkia pasi mua më thanë se nevojiteshin 43 mijë lekë. Më pas ndërhyri Vangjushi dhe ky problem u zgjidh. Teksa unë merresha me këtë problem tezja ndërkohe ishte varrosur me shpenzimet e bashkisë" sqaron ai. Ndërkohë ai pranon se nuk i kanë munguar propozimet për t'ia zgjidhur situatën në të cilën ata ndodheshin të cilat ai dhe tezja i refuzuan. Kështu ata nuk pranuan që të shkonin në azil sikurse e ka parashikuar edhe akti normativ i qeverisë Berisha. Po kështu edhe strehimin provizor tek Qendra Ditore e të Moshuarve e hodhën poshtë. Propozimi i fundit ishte një



Llazar Qendro

dhomë në Porto Romano të cilën e ofroi një biznesmene. "Tezes nuk i pëlqente sistemimi në Porto Romano se ishte larg Durrësit" tregon Llazar.

**ZGJIDHJA**

Llazar Qendro thotë se ai do të strehohet në një garso-

nierë ndërsa Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako sqaron pozicionin e bashkisë lidhur me këtë rast. "E kemi kundërshtuar me kohë vendimin e qeverisë Berisha dhe kemi paralajmëruar ngjarje të rënda si kjo që ngjau në Durrës". Por megjithatë ai sqaron

**LLAZARI**

"Varrimin e tezes e bëri bashkia pasi mua më thanë se nevojiteshin 43 mijë lekë. Më pas ndërhyri Vangjushi dhe ky problem u zgjidh. Teksa unë merresha me këtë problem tezja ndërkohe ishte varrosur me shpenzimet e bashkisë"

propozimet e bëra për sistemimin e tezes dhe nipit të saj si dhe refuzimet e tyre ndaj këtyre propozimeve. Ai shton se "do të bëjmë çfarë është e mundur për strehimin e 5 familjeve të cilat janë në kushte mjaft të rënda nga kjo kategori e të pastrehëve. E kemi shumë të vështirë edhe me banesat sociale pasi ato ndahen me sistem pikëzimi dhe i përfitojnë vetëm ata që kanë mundësi shlyerje" thotë Llazar.

**LAJME SHKURT**

**Itali, vjedhjet e banesave, në pranga banda e shqiptarëve**  
Janë vënë në pranga në flagrancë pesë të rinj shqiptarë mes tyre dhe një vajzë, pasi akuzohen për vjedhje banesash. Policia e Trevizos në Itali, ka vënë në pranga Indrit Salliu 23 vjeç, Ilir Kokaj 27 vjeç, Emanuel Likën 24 vjeç dhe Bruxhino Murati 20 vjeç. Në pranga ka rënë dhe një vajzë 23 vjeçe, emri i së cilës nuk bëhet i ditur. Të arrestuarit akuzohen se gjatë muajit shtator kryer një seri vjedhjes në banesa private në provincën e Pordenonës dhe Trevizos. Gjatë natës mes 3 dhe 4 tetorit banda akuzohet se ka vjedhur një apartament në Pravidomoni dhe kishte vazhduar për të bërë goditje të tjera.

**Dritan Dajti në seancë: 4 policët ishin të veshur civilë**  
Dajti, i pranishëm në seancën e djeshme, ka akuzuar sërish Gjykatën dhe organin e akuzës, për manipulim provash, pasi, sipas tij, ai akuzohet për vrasje në rrethana cilësuese të policëve në një kohë kur viktimat Alket Dizdari, Fatos Xhani, Kastriot Feska dhe Sajmir Duçkollari, në momentin e ngjarjes ishin të veshur civilë, me bluzë, xhinse dhe atlete dhe nuk kishin asnjë shenjë dalluese me logo apo uniform policie.

**Konflikti**

## Sulmi ndaj shoferit të deputetit Sadri Abazi, në një pikë bastesh

**TIRANE**

Sulmohet me armë makina "Benz Mercedes ML" ngjyrë e zezë në pronësi të shoferit të deputetit të PS-së, Sadri Abazi. Burime nga policia kanë bërë të ditur se, ngjarja ka ndodhur mesnatën e së dielës në rrugën "Babë Rexha", në zonën ish-parkut të autobusave. Nga të dhënat e para mësohet se shoferi i deputetit, i identifikuar me emrin Nazmi Kaca është sulmuar pas një grindjeje në një pikë bastesh, ku pas zënkes mes dy miqve të tij, ai ka ndërhyrë për të shuar sherrin, duke u sulmuar më pas edhe vetë. Lajmi është konfirmuar mëngjesin e djeshëm nga burimet të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme që nën hetimet dhe disa orë më vonë zbardhën ngjarjen, duke nxjerrë në pah se ngjarja nuk ka lidhje me deputetin Abazi, por me një grindje në një pikë bastesh. Sipas policisë, konflikti ka nisur ndërmjet Erjon



Sadri Abazi dhe shoferi i tij (në rreth)

Priftit dhe Erjon Mihalit në një pikë bastesh, ku Mihali ka tentuar të vrasë Priftin, ky i fundit shok i Kacajt. Kacaj ka shkuar për të shuar sherrin, ndërsa ka dhe vetë ka rënë për e agresionit duke u sulmuar. Konflikti në të cilin mbrëmjen e djeshme janë përdorur armët, ku është përfshirë dhe Nazmi Kaca, shoferi i deputetit Sadri Abazi, ka nisur pas një grindjeje në një pikë bastesh. Erjon

Mihali dhe Erjon Priftit janë konfliktuar, ndërsa Kaca ka shkuar për t'i ndarë, por ka rënë pre e sulmit. Policia ka shpallur në kërkim Mihalin për tentativë vrasjeje, pasi ky i fundit ka tentuar të vrasë Erjon Priftin, shokun e Kacajt. Ndërkaq, deputeti i PS-së, Sadri Abazi në një prononim për TV A1 Report thotë se, nuk ka pasur dëgjim për ngjarjen, të cilën e ka mësuar nga media.

**Çfarë dini për ngjarjen zoti Abazi?**  
Nuk kam asnjë dëgjim në lidhje me këtë ngjarje, tani po e mësoj nga mediat. Shoferi ishte në mëngjes, normal, erdhi dhe më mori me makinë. Tani jam në komision. Shoferi ishte absolutisht normal, erdhi më mori më solli në punë dhe lëvizti para 5 minutash.

**Shoferi juaj është Nazmi Kaca?**  
Po, por nuk është e vërtetë ngjarja, pasi shoferi nuk ka asnjë lloj shqetësimi, sepse ishte me mua dhe kjo është një gënjeshtëri.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA DURRES**

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 223 10, e-mail: info@Durrës.gov.al

---

**Bashkia Durrës mbështetur në Udhëzimin Nr. 15 date 24.07.2007**  
"Për kriteret dhe procedurat e leshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar, dhe në Urdhërin nr. 98 dt.03.10.2013 të Kryetarit të Bashkisë shtpall konkursin e hapur për të gjithë subjektet juridike që operojnë në fushën e transportit për përzgjedhjen e kandidatit për operim në linjën nderqytetase Durrës-Gjrokaster-Durrës dhe Durrës-Fier-Durrës. Të gjithë të interesuarit janë të lutur të theqejn dokumentacionin e konkurimit duke filluar nga data 08.10.2013 në Sektorin e Transportit ne Drejtorine e Sherbimeve prane Bashkise Durrës ne adr. Lagjia Nr.3, Sheshi "Liria" Durrës. Afati i fundit i dorezimit të dokumentacionit eshte data 07.11.2013. Dorezimi do te behet prane Komisionit te Vleresimit me date 07.11.2013, ora 10.00 prane Bashkise Durrës ne adresen e mesperme. Per cdo hollësi e sqarime te metejshme kontaktoni me Drejtorine e Sherbimeve (Sektorin i Transportit) ne Bashkine Durrës".

## Satirë



NGA ARBEN DUKA

(Sipas Biblës-Dhjata e Re; nga letra e parë e Shën Palit dërguar korintasve)

vijon nga faqja 1

## Epërsia e pashoqe e dashurisë..

Gjuhët e engjëjve të dija, nuk do më qeshte kurrë nuri, po të mos ishte dashuria, do isha si një copëz guri.

Dhe po të kisha gjithë dhuntitë, të qe veç imja profecia, do isha një kandil pa dritë, po të mos ishte dashuria.

Sikur të kisha gjithë fuqinë, nga vendi malet të lëvizja, po të mos kisha dashurinë, as dhe një shkapë dot s'do t'ndizja.

Të ndaja pasurinë të tërë, për të ushqyer varfërinë, do isha thjesht një kokërr rërë, po të mos kisha dashurinë.

Sikur ta falja trupin tim, të digjej dhe të bëhej hi, kjo sakrificë s'do kish kuptim, po të mos kisha dashuri.

Sepse Ajo është zëmërgjerë, një Univers me mirësi, fryma e shenjtë për të tërë. është kryeulur-s'ka zili!

Duron atë që nuk durohet, dhe të pamundurën shpreson, magji e saj s'mund të kuptohet, nga një njeri që s'dashuron.

Pa dashuri-shpresë e besim, ku do të mbahej njerëzia, po dashuria- pa dashim, është më e madhja nga Të Trija.

Kur profecira më s'do ketë, edhe mistere më s'do ketë, të gjitha gjuhët do të shuhen, po dashuria do të jetë.

Po dashuria do të jetë, edhe në ndodhjet perëndimi, veç nga ajo në të vërtetë, do nisi jeta nga fillimi.

1982-2013

(Shqipëruar nga origjinali i greqishtes së vjetër me konsulentin e Nlase Fidhit në vitin 1982, në Gjirokastër. Botohet për herë të parë)

## Ku është humanizmi o njerëz të ndyrë?!

(Sarkazëm)

E di ç'do të thotë, i varfër-i pasur, nuk është ky sistemi, nuk unë kam dashur.

Që kur kam kuptuar, botën në fillim, desha barazi, edhe vllazërim.

Komunizmi kish, situatë të keqe, po "sistemi i ri", ka më shumë hendeqe.

Hendeku i madh, çdo ditë po thellohet, tani barazia, as mund të mendohet.

Borgjezia ka, pallate me vlerë, ku të fusin kokën, nuk kanë shumë të tjerë.

Dikur shkroi Migjeni, në vitet tridhjetë, për një bukuri, që njeriun vret.

Mbase requeimin, mënd e mbani mirë, për një vajzë të vogël, në acar të ngrirë.

Bukurinë që vret, e gdhëndi Ai, për një vajzë të vogël, që s'kishte shtëpi.

Skena Migjeniane, krejt e njëjtë ndodhi, bushtra borgjezi, njerzit në rrugë hodhi.

Gjithmonë është vdekja, bukuri që vret, që të gjithë e pamë, tek një plakë e shkretë.

Ky kapitalizëm, që jetojmë prore, ka një fytyrë kafshe, aspak njerëzore.

Sot ky lloj sistemi, më shpif neveri, kur shoh si në stol, e vret një njeri.

Nga vendi në vënd, ndryshon borgjezia, tonën e sundon, veç makutëria.

Këtë sistem plehrë, këtë borgjezi, në kulm të urrejtjes, unë e pështy!

Të vdekur-të akullt, shoh një plakë të ngrirë, ku është humanizmi, o njerëz të ndyrë.

Ju kam thënë-të varfër, tok s'jemi të huaj, ky pushtet është gjarpër, s'është pushteti juaj.

Boll na i çatë veshët, me demagogji, tek ju asnjë vlerë, s'ka fjala "Njeri"

Dihet, borgjezia, është një klasë mizore, ndaj duan t'i japin, fytyrë njerëzore.

Ka një shekull bota, për këtë lufton, po qytetërimi, këtu s'fukSIONON.

Këtu s'fukSIONON, po e them pak butë, pak a shumë borgjezët, këtu janë hajdutë.

Pak a shumë borgjezët, këtu janë hajdutë, dhe plaçka e vjedhur, i ka bërë harbutë.

Një plakë e sëmurë, shpirtin dha atje, ta ketë si kurban, qeveri e re.

Shqipërinë në këmbë, e mbajnë fukarenjtë, po mallin dhe gjënë, e kanë maskarenjtë.

Mos mendo se tänden, e ke qeverinë, ajo si kudo, është për borgjezinë.

Ndonjë mrekulli, nuk ke pse të presësh, vërtetë je i lirë, por vetëm të vdesësh.

Liria që thonë, është demagogji, në xhunglën e thellë, ka më shumë liri.

Këtu një nga një, do na vijnë mandatat, nëse me urgjencë, s'ngrihen sindikatat.

I them vegjëlisë, nëse më dëgjon, po s'u mbrojtje vetë, askush nuk të mbron.

Forcë e fukarenjeve, përmbi gjithë mandatat, është tek vllazërimi, dhe tek sindikatat.

Se në mëndje njerzit, kanë një handicap, pa bashkim-e keqja, kurrë s'bëhet zap.

Mos mendoni Ramën, bir të vegjëlisë, ai i shërben, vetëm borgjezisë.

Jo se nga inati, këto fjalë i themi, kjo është e vërteta, se ky është sistemi.

Kjo është situata, tani o të giorë, ky s'e ka më emrin, pushtet popullor!

Qeverinë që kemi, kjo gjë s'e cënon, po shteti bën ligje, që të varfërin mbron.

Pa ligje të tilla, shteti është gogol, dhe e çon njeriun, të vdesë në stol.

Për çdo hall që kini, më dëgjoni mua, shteti s'bën asgjë, po s'u detyrua.

Ndaj bëhen revolta, edhe demonstrata, që ne të dëgjojmë, sa më pak mandata.

Këto që citova, i kam në parim, nuk ju nxis kaq shpejt, në një rebelim.

Po s'do lëmë kërkënd, që të na gënjejë, që me dinjitet, vendit t'i shërbejë.

Shërbëtorë nuk dua, të them të vërtetën, po ligje të forta, që të mbrojnë jetën.

Ligje në favor, të gjithë vegjëlisë, që të mos i shtypni, dhunë e borgjezisë.

Ramën mund ta doni, fare pa hile, po duhet ta dini, që s'është një nga ne.

Nuk po shkruaj kot, këtu një sofizëm, po tani ne jemi, në kapitalizëm.

Ky është pak a shumë, rendi botëror, Ramës i kërkohet, ta bëjë njerëzor!

NGA ARBEN DUKA

6 tetor 2013





**Ndryshe**

# Veza e kuqe



NGA EDISON YPI

vijon nga faqja 1

...kakariseje, ngrehje. Nuk i kam parë kurrë unë këta të bëjnë ndonjë gjë tjetër veç vezës së kuqe. As në diktaturë, as tani. Dhe kudo ku kam qënë jashtë Shqipërie, vetëm duke bërë vezë të kuqe, dhe vetëm duke kakarisur e duke u ngrhur i kam parë. Këta janë gjithë kohën në garë me njëri-tjetrin kush e kush të bëjë sa më shpejt vezën, sa më të kuqe, dhe me sa më tepër kakarisje. Këta frymë nuk marrin, këta nuk gdhihen as nuk ngrysen dot, këtyre jeta nuk j'u ka lezet, po nuk bëjnë vezë të kuqe. Këtu, i riu, i vjetri, i sëmuri, i shëndetshmi, i punësuar, i papuni, të gjithë vetëm vezë të kuqe bëjnë. Këta vezën e kuqe e bëjnë kudo; Në shtëpi, në rrugë, në kafene, në zyrë, në gazetë, në televizion, në qeveri, në Parlament. Këta vezën e kuqe e lëshojnë mu aty ku janë, mu aty ku j'u vjen. Dhe jo se vezën e bëjnë të bardhë dhe pastaj e lyejnë me të kuqe si vezë Pashke. Jo mor jo. S'ka lidhje veza e kuqe e Pashkës me vezën e kuqe të shqiptarit. Këta me vezën e kuqe mburren. Këta vezës së kuqe i kanë kushtuar edhe një shprehje. Atë që thotë për filanin apo fistekun se "bën vezën e kuqe". Që domethënë se ai që bën vezë të kuqe ka bërë gjënë më të madhe, sakrificën më të lavdërueshme, punën më të lavdishme. I ziu njeri, duke parë këtë tendencë mbarëpopullore për të bërë vezë të kuqe, nis e mendon, nis e vihat në dyshim, nëse vërtet bëra e vezës së kuqe mund të jetë puna më e dobishme. Por nuk kupton dot asgjë, dhe nuk del dot në asnjë përfundim.

S'është parë e dëgjuar kurrë dhe askund që bëra e vezës së kuqe t'i konsiderohet meritë dikujt, aq më pak një populli të tërë. Dytënjaja mburrin tjetrin për punë të mëdha. Kur janë politikantë dhe bëjnë reforma të rëndësishme, për shembull. Ose kur janë inxhinierë dhe bëjnë projekte ose shpikje. Apo artistë, shkrimtarë, poetë, muzikanë, dhe bëjnë Art të madh të njohur në të gjithë botën. Pra dytënjaja mburr atë që lodhet shumë, ka rëndimet të madh, dhe bën për të mirën e të gjithëve gjëra që mbeten.

Këta jo. Këta nuk bëjnë asnjë punë. Këta bëjnë vetëm vezë të kuqe. Këta, nga më fukarakt tek më zengjini, nga më idioti tek më inteligjenti, nga më primitivi tek më i sofistikuar, ilar kush ta bëjë vezën sa më të

madhe, sa më të kuqe, me sa më tepër kakarisje.

Këtu vezë të kuqe bën edhe plehraxhiu i kazanave. Edhe muhabetçiu i kafenesë. Edhe llafazani i turmës. Vezë të kuqe këtu bën gazetari i redaksionaleve. Vezë të kuqe këtu bën politikanin e përdredhjeve. Vezë të kuqe këtu bën nostalgjiku orëmbetur. Madje këtu vezën e kuqe më të madhe dhe më të kuqe se të gjithë të tjerët e bëjnë ata që me vezën e kuqe dhe kakarisjet s'kanë asnjë lidhje; i përndjekuri dhe i shpronësuar, ballisti dhe monarkisti, besimtari musliman dhe besimtari kristian.

Mund të bënin gjëra më të veshme se veza e pulës, dhe me ndonjë ngjyrim më interesant. Mund të bënin, për shembull, në vend të vezës së kuqe të pulës, ndonjë gjë më të arsyeshme dhe më të dobishme, si, ta zemë, qingim e bardhë të deles, vicin laraman të lopës, gcin e bardhë të derrit, apo ndonjë produkt tjetër ani-

malistik. Mund t'i bënin këto si të donin, duke blegëritur, duke pëllitur, lehur, hunguritur, gërrhitur, mjaullitur. Por këta nuk bëjnë asgjë nga këto. Këta bëjnë vetëm vezë, vetëm të kuqe, vetëm duke kakarisur.

Do ishte deridiku e kuptueshme gjithashtu sikur të bënin, makar edhe vezë, po deshe edhe të kuqe. Por jo vezën e pulës. Që është një shpend i mjerë që ha gjithëcka nga guri tek muti. Mund të bënin pra, në vend të vezës së pulës vezën e një shpendi të lavdishëm, vezën e shkabës. Që do ishte vërtet një punë më ment. Për më tepër që shkabën e kanë edhe në flamur, dhe dihen gjërat e mira që bartin shkaba dhe flamuri si simbole me rëndësi të pazvendësueshme kombëtare.

Por këta jo. Këta, në çdo rrethanë, në çdo kohë, me çdo kusht dhe me çdo qmim, vezë dhe vetëm vezë, të kuqe dhe vetëm të kuqe.



Nuk është fjala këtu për të mohuar vlerat e pamohueshme ushqimore si të pulës dhe të vezës, efektin relaksues të kakarisjes, efektet çudibërëse të së kuqes. Se pula dhe veza, të zjera apo të skuqura, hahen dhe bëjnë mirë, kakarisja vjen dhe s'ke ç'i bën, dhe e kuqja në fund të fundit ekziston, dhe edhe asaj s'ke ç'i bën.

Po atëhere pse vallë të jenë fiksuar kaq fort vetëm pas vezës, kakarisjes dhe të kuqes?

Vezën e kuqe nuk e merr dot në konsideratë as si "Veza e Kolombit". Se në diskutim nuk është asgjë që të ketë lidhje me ekuilibrin, aq më pak me kakarisjen, e aq më pak akoma me të kuqen, nga e cila vetë Kolombi nuk ka pasur ndonjë ide.

I vetmi cengel për ta zh-dredhur enigmën torturuesve të pjellorisë së pafundme shqiptareske me vezë të kuqe duket se mbetet zogu i vezës. Ai qamarroku, ai filizi, ai pionieri

i kuq që del duke u përpëllitur nga guacka që sapo e ka çikatur me sheq kllçoça.

Ai po. Duke dalë nga veza e kuqe, i kuq do jetë dhe vetë, dhe gjithë jetën do kakarisë sa do pëllesi. S'ka rrugë tjetër për ta garantuar të ardhmen e kuqe.

Nëse tendenca shqiptareske e vezës së kuqe nuk spjegohet as me zoçkën e kllçoçës, i vetmi spjegim për shkoqjen e enigmës së kaq shumë vezëve dhe kaq shumë kakarisjeve mbetet të jetë fakti se veza del nga bytha, natyrisht e kuqe, ç'ka i shpjegon të gjitha pa qënë nevoja t'i futemi brenda.

Nga nis e deri tek bitis, nga fillon e deri tek mbaron, nga len tek perëndon, nga lart e deri poshtë, nga e majta në të djathtë dhe rrumbullak, veza e kuqe po bën hatanë. Gjelat janë kthyer në pula. Kënga në kakarisje. Shtëpitë në koteca. Jeta publike në inkubator. Shqipëria në pulari. Të gjitha të kuqe. Si veza.

**Koment**

# Etërit dhe bijtë



NGA ARBEN SALIU

vijon nga faqja 1

...anatemuse se "ashtu si përmbysem etrit, ashtu do jua bëjmë edhe juve bijve të tyre". Personalisht mendoj se kjo çfryrje mllëfi nuk ka asnjë sens logjik. Shoqëria ime është shumë e gjerë dhe e larmishme, por asnjëherë në jetën e përditshme nuk jam kondicionuar në raportet tona nga bindjet e ndryshme politike mes njëri -tjetrit. Gjykoj se nuk është aspak e drejtë të bëhen atakime parçjale, pasi brezi i etërve tanë nuk pollën vetëm fëmijë që aderuan majtas, por edhe djathtas. Le të flasim konkretisht. Babai i jetës tërë anëtare e Komitetit Qendror të PPSH dhe njëkohsisht ministër në kabinetet e Mehmet Shehut; babai i Genc Pollos, drejtor i Institutit të Historisë; babai i Genc Rulit, kolonel i regjimit të Enver Hoxhës; babai i Ilir Rusmalit, këshilltar i Ramiz Alisë dhe drejtor i përgjithshëm i Radio Televizionit; vjehri i Zana

Guxhollit, sekretar i parë në rrethet të ndryshme dhe ambasador në disa shtete; vjehri i Adriana Gjonit, zëvendësuesi i Bardhok Bibës në postin e sekretarit të parë të Mirditës e të tjerë shembuj që s'dua t'i përmend. Lufta e ndershme politike duhet bërë nga këndvështrimi i programeve dhe jo biografive rracore. Unë personalisht e kam për nder që jam pasardhës i një luftëtari antifashist dhe një ish komunisti të ndershëm deri në palcë, që megjithëse dha shumë, nuk ju ndanë sakrificat të jetës. Kjo kategori ishte një armatë e tërë. Por logjika se ata që aderuan majtas në pluralizëm, i kanë etrit djaj, kurse ata që aderuan djathtas janë bijtë e etërve ëngjëj, është e papranueshme. Ky është koncept tërësisht emotiv dhe jo realist. Është mëse e vërtetë se Levizja Studentore përshpejtoi ardhjen e pluralizmit politik. Studentë në atë kohë nuk shkonin bijtë e të përndjekurve politikë të regjimit, por të atyre të lidhur me fije të ndryshme me të. Në këtë kontekst, studentët dhe pedagogët morën nga etrit kurajon dhe guximin e rinisë së tyre për të përmbysur çdo gjë të vjetër, në sistem apo koncept, duke u bërë promotorë për t'i hapur rrugë hapësirave të gjera të lirisë, në emër të demokratizimit të jetës së vendit, një proces që kishte përfaqësuar Evropën Lindore. Pra kjo fitore e madhe për të ardhmen e vendit erdhi në rradhë të parë nga fëmijët e etërve që kishin imunitet politik dhe jo nga fëmijët e kuisingëve, balistëve, zogjstëve dhe diversantëve që regjimi ju kishte marrë erzin qysh në djep. As më thotë ndonjë mik pse liderët e forcës së parë politike antikomuniste ishin nga kategoria me



biografi të mirë dhe jo nga pinjollët e së djathtës tradicionale dhe pse kjo forcë u krijua në shtëpinë e Eleni dhe Josif Pashkos në Tiranë dhe jo të Pjetër Arbenorit në Shkodrën antikomuniste?! Po Fatos Nanua, Edi Rama, Ardian Klosi, Teodor Kekua etj e nuk ishin bij etërish me potencë politike e shoqërore, që dhanë shembullin qysh para pluralizmit politik se frika duhet vrarë në rradhë të parë nga ky shtresëzim?! Dhe këta etër jo vetëm nuk u bënë pengesë të bijve të tyre, por gradualisht përfaquan alternativën më progresive të kohës duke u distancuar nga dogmat e marrëzisë e kohës, por jo nga vlerat e së shkuarës. Ne jemi bij të këtij trualli, të djathtë të të majtë qofshim, që kërkush nuk duhet paragjykuar se nga vjen, por çfarë bën dhe jep për prosperitetin e këtij vendi. Nëse duam të rikthejmë luftën e klasave, atëherë shteti demokratik do vazhdojë të rrëshkasë nga dita në ditë në një neodiktaturë me maskë demokratike. Gjykoj se të gjithë aspirojmë për një shtet sa më demokratik dhe për këtë duhet të punojmë çdo ditë dhe të zhveshur nga çdo mentalitet i partisë-shtet.

Bertol Brehti thoshte se ai popull që ka nevojë për patriotë është i mjerë. Dhe nëse populli shqiptar nuk është i mjerë, është edhe nga fakti se baballarët tanë ishin patriotë të mëdhenj, pasi në rininë e tyre i vunë kuroren e lavdisë Shqipërisë si vend fitimtar ndaj bishës nazifashiste dhe me pas e transformuan atë në një vend me drita, arsim, kulturë, shkencë, industri moderne, bujqesi intensive, shërbim mjekesor falas, forca të armatosura dinjtoze e plotë tregues të tjerë. Formen e sistemit politik dhe deformimet që ai pësoi në rrugë e sipër nuk është mëkat i baballarëve tanë. Atë ta mbajnë ata që ndanë hartën e botës në Jaltë si dhe ata që drejtuan këtë vend pasi u dehën nga pushteti.

Unë jam partizan i filozofisë së bashkë me ujë e pistë të legenit nuk mund të hidhet poshtë edhe foshnja. Vazhdoj t'i mëshoj kësaj filozofie, pavarësisht se kush më përkrah, rruhd buzët apo jargavitet.

Prandaj ata që i bien borisë së çjerërë të etërve dhe bijve të të gjykojnë ftohtë, se këtë vend nuk mund ta bëjë një palë, pasi në luftën politike dikush fiton dhe humbet përkoheisht, por ajo që duhet të fitojë përjetësisht është Shqipëria demokratike.



### Masterat te Filologjiku procesi mësimor shtyhet me një javë

Fakulteti Histori-Filologji do të shtyjë edhe me një javë nisjen e vitit akademik për studimet master. Ndryshe nga sa përcakton urdhri i ministrisë së Arsimit, dekani Rrokaj ka vendosur që të gjitha studimet e nivelit master të nisnin javës që vjen. Sipas tij, vendimi është marrë për shkak të fluksit të madh të kërkesave për të vazhduar studimet për herë të parë në

nivelin master që ofron ky fakultet. Po ashtu në këtë fakultet nuk mbyllur ende sezoni i vjeshtës. "Studentët që mbarojnë Bachelor në fakultetin tonë, automatikisht fitojnë të drejtën me kërkesën e tyre të pranohen në master, kurse për studentët që vijnë nga fakultete të tjera homologe apo të përafërta për ta, kritერი i pranimit do të jetë mesatarja. Ka shumë kërkesa

për marrëdhëniet ndërkombëtare, për arkeologji, histori, gjuhësi dhe sidomos për gazetari, ndaj ne kemi vendosur që të shtyjmë me një javë fillimin e procesit mësimor për të gjithë ata që duan të nisnin studimet në master", - ka shpjeguar dekani Rrokaj. Ndërkohë që në pjesën tjetër të universiteteve publike, dita e djeshme ka qenë dita e parë edhe për nisjen e masterit.

## Të enjten votimi në parlament, AKIP: Vendimi i duhur

# Plehrat, ndryshon ligji i importit

### Ricikluesit: "OK", por na krijoni lehtësi

#### LAJMI

Nenet që lejojnë importin e mbetjeve në vendin tonë do të ndryshojë krejtësisht, duke hequr nenet që lejojnë që të futen mbetje për qëllim riciklimi. Ndonëse vetëm me votat e mazhorancës në komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, ndërsa të enjten do të kalojë për votim në parlament.

■ ■ ■ TIRANE  
ESMERALDA KETA



shqiptarë të ndajmë mbetjet, si e bëjmë ne këtu në parlament? **Vullnet Haka:** Industria e riciklimit është thellësisht e interesuar për të siguruar lëndën e parë brenda vendit dhe në këtë pikë e mbështet qeverinë për ndalimin që bën në mënyrë ekskluzive për mbeturina e për-

ziera dhe gjithashtu inkurajon qeverinë në masat që sapo ka filluar të marrë për menaxhimin e integruar e mbetjeve në vend që do të çojë edhe për sigurimin e lëndës së parë të kompanive të riciklimit të cilat kanë investuar mbi 120 mln euro në industrinë e riciklimit dhe punësojnë mbi



### "Merr fund era Berisha për importin e mbetjeve"

Pas miratimit të ndryshimeve në komision, deputeti socialist Erion Braçe ka reaguar në "Facebook"

NGA ERJON BRACE

"Të enjten, Kuvendi i jep fund "ERES BERISHA" të importit të mbetjeve në Shqipëri! Komisioni i veprimtarisë Prodhuese dhe ai i Integritimit të Kuvendit i dhanë fund sot shqyrtimit të ligjit në këto komisione. Të enjten shqyrtimi në seance plenare dhe votimi!! Ndërkohë; qeveria duhet t'i hapë rrugë menjëherë të gjithë procesit të ndarjes së mbetjeve dhe të shfrytëzimit të mbetjeve të vendit për riciklim. Kjo është jetike për të pastruar këtë vend".

Postuar në Facebook në orën 19:00, 7 tetor 2013

#### LAJME SHKURT

■ **Basha uron nga Elbasani: Studentë, studioni shumë**  
Lulzim Basha, kreu i Partisë Demokratike, ka zgjedhur të urojë studentët për nisjen e vitit akademik nga universiteti i Elbasanit. "Kam kënaqësi të rikthehem sot me rastin e fillimit të vitit akademik, në qytetin që kam pasur nderin ta përfaqësoj në Kuvendin e Shqipërisë. Uroj një vit të mbarë e suksese, kjo është ditë e veçantë për shumëkënd që është ulur si student, ditë ku rifilloni apo filloni studimet dhe mezi prisnin të mbaroni, ndërsa të tjerë kujtojmë me mall vitet që kanë lënë pas"- u shpreh Basha.

■ **Bursat e BE për studentët elitare, sot hapet projekti**  
Universiteti i Tiranës do të hapë sot projektin JoinEU-SEE PENTA, të programit Erasmus Mundus të Bashkimit Europian. Takimi do të zhvillohet në rektoratin e UT-së, në orën 9:30. Në këtë projekt marrin pjesë përfaqësues nga 30 vende të Europës dhe Ballkanit Perëndimor, të cilët do të jenë të pranishëm në takimin e prezantimit të këtij projekti ambizioz, nga i cili kanë përfituar edhe mjaft të rinj shqiptarë. Në ceremoninë e hapjes do të marrë pjesë Rectori i Universitetit të Tiranës Prof. Dr. Dhori Kule dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla.

### Shkollat e larta

# 60 universitete hapën dje auditoret

Ministrja Lindita Nikolla te Ekonomiku: Ne presim shumë prej jush, nuk ka më censurë

■ ■ ■ TIRANE

Plot 60 shkolla të larta, private dhe publike në të gjithë vendin, kanë hapur dje auditoret për të pritur studentët. Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla, ka zgjedhur fakultetin e Ekonomisë të Tiranës të përcjellë mesazhin e saj të urimit, në këtë ditë të veçantë. "Ne presim shumë prej jush, prej generatës tjetër të shqiptarëve, generatës së ekonomistëve e të financierëve të rinj. Një bashkëpunim midis gjeneratash do të mundësojë kapërcimin e sfidave të mëdha që vendi ka përpara", - u shpreh Ministria e Arsimit dhe Sportit. A Ministria Nikolla ka vënë theksin dje se auditorët janë diruar nga presioni dhe censura politike.



Ministrja e Arsimit Lindita Nikolla

"Epoka pa censurë dhe pa nënshtrim politik i auditorëve studentorë sapo ka filluar. Në çdo universitet, jashtë orëve të mësimi mund të bëhen lirish bashkëbisedime edhe me politikanë e përfaqësues të opozitës, përveç se me përfaqësues të qeverisë", - ka deklaruar ministria e Arsimit.



### "Studentë, forcë ëndrash dhe kurajo për të ecur drejt të nesërme"

Kryeministri Edi Rama ka postuar urimin e tij për studentët ditën e parë të vitit të ri akademik universitar 2013-2014

NGA EDI RAMA

Në këtë fillimvit të ri akademik dua t'i uroj studentëve forcë ëndrash, synimesh dhe kurajo për të ecur drejt të nesërme pa u tërhequr nga vështirësitë. Jetësimi i ëndrave dhe realizimi i synimeve të tyre është jetësimi i Shqipërisë së Gjeneratës tjetër. Është misioni i qeverisë sonë. Me stafin akademik jemi partnerë në këtë mision, i cili orientohet

nga forca e aspiratave dhe shpresave të brezave të rinj. Me emocionin e një kohë të re të filluar për vendin, që përkon me kohën e re të këtij viti akademik, përcjell urimet e përzemërta për sukses të gjithë studentëve dhe për një vit të mbarë të gjithë stafit akademik.

Postuar në Facebook në orën 14:00, 7 tetor 2013



# In Memoriam

**AMANETI:** "Këshilla ime është që të mos qajnë dhe të mos vishen me të zeza... Arkivi i jetës sime, të vendoset në arkivin e shtetit."

ZENEPE LUKA

**M**e Dritën bisedoja dy herë në ditë në telefon. Gruaja që i shërbente, Miranda, që Drita i kishte vënë epitetin "e mrekullueshme", jo pak raste më thoshte: Sapo mori qetësues dhe e zuri gjumi. Merre pak më vonë", por sapo ajo dëgjonte zërin tim, i thoshte: "Ma jep Zenepen, flet nga Vlora". Pengu i saj ishte pamundësia për të marrë pjesë në veprimtaritë që organizonte Fondacioni "Nermin Vlora Falaschi", ku ajo nuk mungonte kurrë. Vetëm 3 ditë përpara se të ndërronte jetë, që ishte edhe biseda e fundit, më tha:

Cfarë aktiviteti kemi këtë muaj?  
-Do të shkojmë në Mitrovicë, bëhu gati-i thashë.

-Ku vihet me karrocë në Kosovë, që më qan zemra për ta parë. Lum si ju, nuk mund ta marrësh dhe mend se si ndjehem kur ikni dhe unë mungoj, rri këtu vetëm. "Do të festojmë edhe 70-vjetorin e lindjes së Rozës"- i thashë.

-Do të mbledh forcat që të vij, të mblidhen ndoshta për herë të fundit me koleget, me zonjat e Fondacionit. Nëse nuk mundem, të lutem do t'i dërgosh një buqetë të madhe me lule, aq të madhe, aq të bukur, sa ajo që më sollti mua kur festuam bashkë 85-vjetorin e lindjes sime. Aktorja la këshillën e saj të fundit për Fondacionin: "Misioni ynë është që të kontribuojmë për të ngritur lart vlerat e gruas shqiptare"

**"TË PRES MË 3 TETOR PËR TË DHËNË INTERVISTËN"**

Më tre tetor e lamë bashkërisht, edhe me Tinka Kurtin, që të takoheshim. Drita në këtë telefonatë që u fiksua e fundit u gëzua shumë që do të shkonim në shtëpi dhe më tha: "Ka një javë që më sollën librin e ri, që flet për mua. I kanë vënë titull të bukur "Duke biseduar me Drita Pelinkun" është përgatitur nga një dashamirës i imi, Flori Slatina, qubet. Elxova me një frymë, sido që e njihja materialin që është hedhur në të dhe i vë notën "Shkëlqyeshëm". Dua të jap një intervistë të shkurtër për të vlerësuar të gjitha ata që kanë shkruar e folur për mua, ndërsa promovimin e lëmë më pas. Dua të mblidhem edhe njëherë, do të vij me karrocë". "Më prit-i thashë, do të vijmë bashkë me Tinkën, kurse promovimin do ta lëmë për ditëlindjen tënde, më 3 dhjetor".

**FJALIMI I FUNDIT I DRITA PELINKUT NË VLORË**

Kjo është fjala e përshëndetjes në Konferencën Shkencore Mbarëkombëtare që u mbajt në Vlorë më 28 nëntor, ditën e 100-vjetorit të Pavarësisë. "Shoqe, mike të dashura, anëtare të Fondacionit "Nermin Vlora Falaschi", miq dhe të ftuar. Ju uroj nga zemra 100-vjetorin e Pavarësisë. Më lejoni në këtë rast të recitoj vargjet e Naim Frashërit "Mëmëdhe". Ju përshëndes me një poezi, që e ka shkruar një grua dhe titullohet "Ju flet nëna".....

Kur kam ikur nga Vlora kam qenë 12-vjeçe, pasi mbarova shkollën fillore. Kam rastin që të kujtoj mësuat e mia të shtrenjta, zysh Ballkëzen,



Aktorja Drita Pelinku

# DRITA PELINKU

## Kujtimet dhe amanetet e fundit të aktores

Si ika nga Vlora, amaneti i babait.  
Përshëndetja në 100-vjetorin e Pavarësisë



zysh Zenepen. Prindërit e mi më regjistruan në Institutin "Nëna Mbretëreshë". Sigurisht që e pata të vështirë të ndahesha nga familja, por dëshira ime ishte të shkollohesha dhe fjala e prindërve ishte ligj. U nisa për në Tiranë me makinën e babait. Kur dualëm nga Vlora, u ndalëm në një pikë nga ku dukej si në pëllëmbë

të dorës qyteti i Vlorës. Im atë më nxori nga makina dhe më tha këto fjalë, që më kumbojnë në vesh sa herë i kujtoj: "Shiko Drita, shiko Vlorën, shiko sa e bukur është. Ti po ikën, ndoshta do të kesh jetë tjetër, do të zësh shumë shoqe e miq, por kurrë të mos harrosh Vlorën tonë, Vlorën e bukur. Vlorën e Ismail Qe-

**Iniciativa**

## Pelinku si një nga themelueset e Fondacionit Nermin Vlora

**D**rita Pelinku ishte edhe një nga themelueset e Fondacionit Nermin Vlora Falaschi dhe gjatë 13 vjetëve aktivitet e tij, por ka dhënë edhe kontribute të mëdha. Ajo është delegatë e Kuvendit të Parë të gruas së shquar që u mbajt në Vlorë më 18 prill të vitit 2002 dhe daljen e saj të fundit në publik e ka mbyllur më 28 nëntor të vitit 2012. Ajo mori pjesë dhe foli në Konferencën shkencore mbarëkombëtare që Fondacioni organizoi në Vlorë me temë "Roli dhe kontributi i gruas në 100 vite pavarësi." Vlorën e donte shumë dhe për vlonjatët do të mbetet e paharruar ceremonia që organizoi bashkia, që pas kërkesës që bëri Fondacioni, i dha titullin e lartë "Qytetare Nderi" e Vlorës. Nuk kish shumë kohë që i kishte ndodhur gjëma, ndarja nga jeta e të bijës Jaroshkës dhe mbesës, e veshur me të zeza, u ngjit në skenë për të marrë titullin e lartë, që iu dorëzua nga kryetari i bashkisë z.Shpëtim Gjika, me lot në sy, u përkul dhe tha: Faleminderit Vlorë. Vlerësimi që të bëni qyteti ku ke lindur nuk mund të krahasohet me asnjë titull sado i përmasave të mëdha gofë. Pra duartrokitjeve të zjarrta Drita përshëndeti të pranishmit duke recituar vjershën, që e kish aq për zemër shkruar nga Lasgush Poradeci "Kënga pleqërishte". Ditën e lamtumirës 100 gra intelektuale të Fondacionit, lot e dhimbje për Dritën. Kishin ardhur nga Kosova, Mali I Zi, drejtues të këtij Fondacioni në këto shtete. Buqeta me lule dhe mesazhe në emër të grave intelektuale shqiptare të shteteve nga vinin, vendosën edhe shkencëtarja nga Prizreni Ajtene Krasniqi, Zylfë Duraku nga Mali I Zi, Teuta Demjaha nga Shkupit, Vitore Leka-Stefa ardhur nga Italia etj.

**RREFIMI**

Kur kam ikur nga Vlora kam qenë 12-vjeçe, pasi mbarova shkollën fillore. Kam rastin që të kujtoj mësuat e mia të shtrenjta, zysh Ballkëzen, zysh Zenepen. Prindërit e mi më regjistruan në Institutin "Nëna Mbretëreshë"

**Në foto:** Fjalimi i fundit në publik i aktores Pelinku

malit. Kudo që të jesh të prezantohesh që je vlonjate dhe se Vlorën e ke në zemër." Kështu ndodhi. Shumë ngjarje kanë ndodhur në jetën time, ka pasur gaz dhe lot, sukses dhe bregta. Kam shkruar në shumë shtete, kam kaluar oqean, por amaneti i babait, ka qenë dhe mbetet në kujtesën time. Kam qenë e pranishme në Vlorë sa herë më kanë kërkuar dhe shumë herë që më ka marrë malli. Megjithatë nuk jam mirë me shëndet, guxova që të vijë ehe në këtë ditë të shënuar të 100-vjetorit të Pavarësisë në konferencën shkencore që organizon Fondacioni "Nermin Vlora Falaschi", pjesë e të cilit jam edhe unë. Kisha shumë ftesa, shumë lutje për të qëndruar në Tiranë, por zemra më urdhëroi të vija këtu,

në Vlorën time, të gdihesha në ditën e 100-vjetorit këtu, në Vlorë, ku më ka rënë koka. Në dhjetor unë mbush 86-vjeç, moshë bën të sajën, por do të ishte bukur që unë të mbyllja sytë këtu, në Vlorë, në këtë ditë të shënuar për të gjithë shqiptarët. Faleminderit Fondacionit "Nermin Vlora", faleminderit ju zonja që keni ardhur nga shumë shtete për të kaluar këtë festë të madhe bashkë!  
Në darkë ajo do të bënte recitim për nënën që ka humbur fëmijën e saj. Drita bëri një homazh për të gjitha nënat e botës dhe sakrificat që ato bëjnë deri në momentin e fundit të jetës. Edhe sot e dëgjoj zërin kumbues të Dritës, më vjen i afërt dhe jehon si një porosi plot kurajë.



## Rreziku

**SI U SHPALL** në listët e 7 më të rrezikuarve perla e trashëgimisë kulturore? Inspektimi I hollësishëm i gjendjes së amfiteatrit nga specialistët europianë të trashëgimisë...

# Europa Nostra dy ditë në Durrës për Amfiteatrin

Një nga 7 më të rrezikuarit në Europë, ekspertiza që do të bëhet për gjendjen e monumentit dhe ndërhyrjet që mund të ndërmerren

**TIRANE**  
ADMIRINA PEÇI

Amfiteatri i Durrësit, i shpallur në listën e 7 monumenteve më të rrezikuara në Europë nga komiteti i "Europa Nostra-s" do të inspektohet për dy ditë nga specialistët të kësaj organizate. Sot dhe nesër një grup ekspertësh të trashëgimisë kulturore nga "Europa Nostra" dhe përfaqësues të Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim, do të jenë në Durrës për të parë nga afër se si mund të zbatohet projekti i diskutuar dhe i miratuar në muajin maj për këtë monument të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore shqiptare. Përveç takimeve me ministrën e Kulturës, kryetarin e bashkisë së Durrësit dhe drejtuesit e institucioneve përgjegjëse, në axhendë janë parashikuar diskutime me grupe ekspertësh për të parë gjendjen dhe mundësitë reale për investim në Amfiteatrin e Durrësit. Raporti i grupit të ekspertëve europianë është mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e këtij monumenti, ndërsa vendimi përfundimtar për të mbështetur financiarisht ndërhyrjet në Amfiteatrin e Durrësit do të merret në 5 dhjetor të këtij viti në Konferencën Europiane për Politikën e Trashëgimisë, që do të mbahet në Bruksel. Aplikimi për ta përfshirë Amfiteatrin e Durrësit në listën e monumenteve të rrezikuara të Europës u krye nga Shoqata për Zhvillimin e Turizmit Kulturor në muajin mars të këtij viti dhe u mbështet nga Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

### NË LISTËN E 7 TË RREZIKUARVE

Përzgjedhja e këtij monumenti u bë duke marrë në konsideratë nevojën emergjente për konservim, ruajtje dhe gërmime të mëtejshme për zbulimin e plotë të këtij objekti me vlera unike historike, arkitekturore dhe kulturore, si dhe rolin e tij në zhvillimin e turizmit kulturor në qytetin e Durrësit, por dhe të turizmit shqiptar. Programi "7 Më të Rrezikuarit" u lanca në janar 2013 si një formë ndërfaqësore publike, duke inkurajuar anëtarët e Europa Nostra të aplikojnë për objekte/monumente përfaqësuese të trashëgimisë kulturore nga vendet përkatëse, që kanë nevojë për më



Amfiteatri i Durrësit

shumë vëmendje, konservim, ndërhyrje restauruese, si dhe mundësi rrijetësimi në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor.

Ndërsa amfiteatri i Durrësit është i pari në listën e 7 më të rrezikuarve e dyta në listë është shpallur Qendra Historike e Nikosias në Qipro. Më tej në vend të tretë renditen Fortifikimet e shekullit të 17-të Vauban në Briançon në Francë, dhe vijohet me Manastirin e periudhës së rilindjes në San Benedetto Po (lokalitet në Itali), Manastiri i shekullit të 15-të në Setúbal në Portugal, Peizazhi i

Rosia Montana, minierë në Rumani dhe Kisha armene e Shën Gjergjit në qytetin turk Mardin.

### AMFITEATRI

Amfiteatri i Durrësit, pothuajse i panjohur deri në vitet '60, kur edhe u zbulua (në vitin 1966) nga Vangjel Toçi, ka vlera të veçanta arkitekturore dhe artistike dhe mund të krahasohet me monumentet e kësaj periudhe të Pompeit dhe Kapuas në Itali. Amfiteatri ka trajtë elipsi me diametër 136 metra dhe lartësi rreth 20 m. Shkallarja për shikuesit

e veshur me pllaka të bardha mermer 15-20.000 veta, ndërsa në arenë zhvilloheshin luftimet e gladiatorëve. Amfiteatri 2700-vjeçar qëndron mes 30 amfiteatrove të zbuluar të botës antike nga Roma deri në Budapest dhe Lion. Për shkak të zbulimit të tij të vonuar, monumenti ka duruar planifikimin kaotik urban dhe dëmtimet e shumta vit pas viti. Sipas vlerësimit të komitetit të Europa Nostra-s kjo perle e trashëgimisë është e kërcënuar nga mungesa e burimeve financiare, neglizhenca e institucioneve shtetërore dhe shkaqe të tjera natyrore.

### Lista

## Përse u përzgjedhën këto 7 monumente

Në Kongresin e mbajtur në Athinë në maj të këtij viti presidenti i Europa Nostra-s Plaçido Domingo tha se "këto monumente dhe site arkeologjike janë përzgjedhur, jo vetëm sepse ata tregojnë një histori interesante në lidhje me të kaluarën tonë të përbashkët, ankorimin e një ndjenje të përkatësisë në familjen

europiane, por edhe për shkak se ata janë shumë të vlefshme për komunitetet lokale, të cilët janë të angazhuar fuqimisht në shpëtimin e tyre." Sipas domingos shpëtimi i këtyre pasurive do të veprojë si një katalizator për ringjalljen ekonomike dhe shoqërore të qyteteve apo zonave të tëra.



Takimet muzikore të dy botëve mes Beratit dhe Tiranës



Festivali "Takimet muzikore të dy botëve", pjesë e ditëve të Trashëgimisë Kulturore Evropiane, sivjet nisi në Berat, qytet i listuar në UNESCO për trashëgiminë kulturore, ndërsa mbremë u zhvendos në Tiranë. Shoqata franko-shqiptare ARGJIRO, që organizon prej 7 vitesh Festivalin Ndërkombëtar "Takimet muzikore të dy botëve", organizoi në Berat dy netë me aktivitetet muzikore në muzeun Kombëtar "Onufri" dhe Muzeun Etnografik ku u përcollën kolazhe muzikore me tingujt e fyejeve të Gramshit, flautit, muzikës baroke nga Italia, lahutës shqiptare, muzikë malazeze, etj. Nata e dytë e Festivalit në Muzeun etnografik në Berat solli rapoden e vetme me lahutë në Shqipëri, Lumturje Nonaj me "Zana e Maleve" nga Lezha.

Festivali i Dancit Modern, 10 sfaqje për spektatorët



Festivali i tetë i Dancit Modern dhe Kontemporan nis sot në teatrin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, që është edhe "selia" e përhershme e tij. Ndërkaq, megjithë numrin e reduktuar të trupave të pranishme, sfaqjet do të jepen edhe në qytetet e Tiranës, Korçës dhe Prishtinës. Drejtori i këtij Festivali, Gjergj Prevazi, thotë se vështirësitë financiare për realizimin e këtij edicioni janë të mëdha, por ndërprerja e tij do të ishte "një lloj pabesie" ndaj spektatorëve dhe specialistëve, që e ndjekin atë. Prevazi thotë se këtë vit do të performojnë 5 trupa, dy nga të cilat nga Italia, si dhe nga Hungaria, Zvicra dhe Shqipëria. Nga 8 tetori deri më 6 dhjetor, ato do të japin 10 sfaqje jo vetëm në salla teatrore, por edhe në sheshe e shëtitorë.





# Konkursi

**NË FAQEN ZYRTARE** të Ministrisë së Kulturës është publikuar një njoftim për konkurrim për drejtorë të rinj për Teatrin e Operës dhe Galerinë Kombëtare



Në listën e librave të rinj që i janë shtuar këtë javë stendave të librarive në kryeqytet ne kemi përzgjedhur 4 prej tyre:

**"PYETJE NË ALBANOLOGJI"**, Libri më i ri i Shaban Sinanit "Pyetje në Albanologji", sjell për lexuesin një sërë tezash dhe studimesh të tij. Ky libër trajton autoritete, argumente e probleme të hershme e të sotme të albanologjisë. "Pyetje në Albanologji" është botuar nga shtëpia botuese "Naimi" dhe kushton 1000 lekë.

**"TË PAFAJSHMIT"** "Të pafajshmit" është romani i parë i Francëska Segalit, dhe vjen si një shëmbull i ndikimit të autorëve të rinj, nga shkriktarët e mëdhenj, por pa rënë në kurthin e tyre. Romani është frymëzuar nga Mosha e Pafajësisë, dhe vjen për lexuesin më i ngrohtë dhe më zbatimës. Autorja e mori temën e një veprë të mirënjohur dhe e bëri të vetën, duke e sjellë në stilin e saj më të gjallë dhe argëtues. Ky romani është botuar në shtëpinë botuese "Dritan" dhe kushton 1000 lekë.

**"PËRSE KOMBET SHKOJNË NË LUFTË"** "Përse kombet shkojnë në luftë" është libri më i ri ai autorit John G. Stoessinger. Ky libër studimor vjen në shqip i përkthyer nga Jorgji Qirjako. Libri është botuar në shtëpinë botuese "Tirana Times & AHS" dhe kushton 1200 lekë.

**"HYRJE NË MARRËDHËNIET NËRËKOMBËTARE"** "Hyrie në marrëdhëniet ndërkombëtare" është botimi më i ri që vjen në shqip i autorëve Robert Jackson dhe Georg Sorensen. Ky libër paraqet traditat teorike më të rëndësishme në marrëdhëniet ndërkombëtare në larinin e tyre. Autorët mbulojnë një gamë të gjërë qasjesh teorike dhe e bëjnë këtë në një mënyrë hetuese, por të kuptueshme. Libri është botuar nga shtëpia botuese "Dudaj" dhe kushton 1000 lekë.

# CIKO DHE SHIMA

## Dy zëvendësimet e para të drejtorëve të kulturës

Drejtuësit e rinj pritet të shpallen pas konkursit, më 18 tetor

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Ministria e Kulturës ka shpallur konkursin për postin e drejtorit të Teatrit Kombëtar të Operës Baletit e Ansambllit Popullor dhe të Galerisë Kombëtare e Arteve. Kuptohet që pas rezulttit të këtij konkursi TKOB e Ansambli Popullor, GKA, do të kenë drejtues të rinj. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës është publikuar një njoftim për konkurrim për vend pune. "Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.173, datë 07.03.2003 konkretisht shkruhet: "Për emërimin, lirim ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit". Ministria e Kulturës shpall konkursin për pozicionet Drejtor i Përgjithshëm në institucionet e mëposhtme: Teatrit Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Galeria Kombëtare e Arteve". Pra në bazë të këtij njoftimi rezultoi se dy drejtorët të institucioneve përkatëse Zhani Ciko dhe Rubens Shima do të shkakohen. Po cilët do të jenë drejtorët e rinj? Shpallja e Ministrisë së Kulturës ka të përcaktuara disa kriterë, ku kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në pozicionin "drejtor i përgjithshëm" në bazë të ligjit "Statusi i nëpunësit civil" dhe, më tej, kriteret specifike që lidhen me karakterin e çdo institucioni. Gjithashtu duket se për të dy drejtuesit mbetet vetëm pak kohë në detyrë, sepse në lajmërimin e Ministrisë së Kulturës shkruhet se "Afati i dorëzimit të dosjeve nga ana e kandidatëve pranë Zyrës së Protokollit në Ministrinë e Kulturës është 18 tetori. Pas shqyrtimit të kandidatëve pritet edhe shpallja e drejtuesve të rinj. Burime nga ministria e kulturës pohojnë se do



Zhani Ciko



Rubens Shima

të bëhen ndryshime edhe në institucionet e tjera, por këto institucione kanë qenë më emergjente dhe më problematike sipas këtyre burimeve. E njëjta mënyrë konkurrimi do të ndiqet edhe me institucionet e tjera ku më të përfolur për shkarkime janë drejtori i Teatrit Kombëtar, Kristaq Skrami, drejtorja e Teatrit të Kukullave, Drejtori i Filmit dhe drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës Apollon Baçe.

### JA KRIERET E KONKURISIT PËR DREJTORËT E RINJ

#### Kriteret e kandidatëve Kriteret të përgjithshme

- Pranohen në këtë pozicion personat të cilët plotësojnë këto kërkesa të përgjithshme:
  - a) Të jenë shtetas shqiptarë.
  - b) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
  - c) Të përmbushin kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
  - ç) Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse.
  - d) Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.
  - dh) Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

#### Kriteret për pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor

- a. Arsimitim profesional artistik ose Menaxhim Art;
- b. Përvojë pune në Teatrin e Operës dhe Baletit;
- c. Veprimtari artistike të suksesshme në TKOB dhe në institucione të tjera të llojit, përfshirë ato ndërkombëtare;
- d. Përvojë në krijimin, vënien në jetë të strategjive të projekteve/aktiviteteve artistike;
- e. Aftësi për të organizuar, menaxhuar, identifikuar prioritetet dhe përcjelljen e tyre në mënyrë sa më të dobishme në staf;
- f. Aftësi të shprehura për iniciativë dhe kreativitet;
- g. Aftësi të dallueshme komunikimi, ruajtjeje dhe zhvillim i kontakteve brenda dhe jashtë institucionit, si dhe me partnerët ndërkombëtarë

#### Kriteret për pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm në GKA

- a. Arsimitim profesional artistik ose Menaxhim Art;
- b. Jo më pak se dhjetë vjet përvojë si kurator arti në galeritë vendëse dhe ato ndërkombëtare bashkëkohore;
- c. Përvojë dhe njohuri në organizimin e punës në një galeri arti në të gjitha aspektet e mirëmenaxhimit të saj;
- d. Aftësi të shprehura për iniciativë dhe kreativitet;
- e. Aftësi të dallueshme komunikimi

## Festivali

# Aleksandër Peçi: Ju rrëfej surprizat e "Pianodrom"

TIRANE

Drejtori i festivalit "Pianodrom", Aleksandër Peçi, rrëfen surprizat e këtij aktiviteti, i cili do të startojë në datën 12 tetor në skenën e Universitetit të Arteve. Ai thotë se "I pari që do të startojë më këtë aktivitet me përmasa ndërkombëtare është mbreti i pianizmit në Spanjë Gillermo Gonzales. Organizatorët e festivalit "Pianodrom" janë në përgatitjet e fundit. E veçanta e këtij festivali është se ai do të jetë me bileta, por herë të parë sipas organizatorëve

është menduar një gjë e tillë në festivalin muzikore në vendin tonë. Sipas drejtorit të festivalit, Aleksandër Peçi, kjo gjë është menduar për t'u dhënë dhe më shumë vlerësimin artistëve, krijimtarisë muzikore.

"Hyria pa bileta e ka zhvlerësuar rolin dhe prestigjin e artistin. Si në çdo vend evropian ku aspirojmë të afrohem arti nuk dhurohet falas", tha kompozitori Peçi. "Pianodrom" do të mbahet nga datat 12 tetor deri më 18 janar në sallën e Universitetit të Arteve. Ky është edicioni i parë i këtij festivali, i cili synon të kthejë



Aleksandër peçi

vëmendjen nga muzika klasike dhe t'u japë më shumë hapësirë vlerave të pianos. Në këtë festival do të luhen vepra nga autorë si: Albeniz, Aliaj, Peçi, Çekiçi, Çene, Chopin, Ibrahim, Shostakovich, Ravel, Khachaturian, Piazzolla, Scarlatti, Rachmaninov, Prokofiev, Godowsky, Alkan, Sina, Simaku, Messiaën, Boulez, Debussy, Stravinsky, Kapustin, Tchaikovsky, Baç, Stockhausen Fedele, Shupo, Tole, Debussy, Kraja, Lelo, Skilja, Berio, Takemitsu, Barber, Scarlatti, Haydn, Zadeja, Lara, Tartari, Rexha, etj. **Dhu.Ha.**



### Talenti

## 10 kuriozitetet, ja kush është Adnan Januzaj

■ ■ ■ TIRANE

Mediat angleze pas dy golave të fundit japin 10 detaje që duhet të dihen për Adnan Januzajn, i cili është kthyer në qendër të vëmendjes ditët e fundit në idhull. 1. Januzaj-emri i tij është vështirë të thuhet ne origjinal në Angli dhe Belgjikë. Variacionet që përmenden më së shumti në media në

thirrjen e Januzajt janë: Janussaj, Janusigh, Yanosajh. 2. Januzaj ka lindur në Belgjikë, u bashkua me Anderlecht në moshën 10 vjeçare. United e ka blerë 16 vjeçar për 297 mijë paund. 3. Januzaj ka lindur në Bruksel, por ai ka të drejtë të zgjedhë mes disa përfaqësueseve për të luajtur. Januzaj ka prindër nga Kosova, gjyshërit kanë prejardhje nga Turqia e lakmon

Serbia. 4. Roy Hodgson ka thënë zyrtarisht se e dëshiron në përfaqësuesen angleze. 5. Januzaj e ka ditëlindjen për një ditë me yje si Ronaldo, Neymar e Tevez. 6. Januzaj ka debutuar me Man United në ndeshjen e edicionit të kaluar ndaj ËBA-së, në barazimin 5 me 5. 7. Januzaj u votua si lojtari më i mirë në akademinë e Manchester United. 8. Adnan Januzaj dhe Rud

Van Nistelroy janë dy lojtarët e vetëm për United që kanë debutuar me 2 gola në një ndeshje ku kanë startuar nga ndeshja e parë. 9. Për Adnan Januzajn janë të interesuara skuadra të mëdha evropiane si Juventus, Barcelona, Bayern Munchen e Manchester City. 10. Emri Adnan rrjedhë nga gjuha arabe që do të thotë 'për të qëndruar'.

### Bushi: Nëse marrim 6 pikë në dy ndeshje ka premio

# De Biasi thotë 'Po' për 1 milion euro

## Kualifikimi, 'Për sa kohe ka jetë ka dhe shpresë'

### LAJMI

De Biasi i ka kërkuar Federatës Shqiptare të Futbollit një rritje prej 30% të kontratës, krahasuar me atë që ka firmosur dy vite më parë, kjo rritje shkon në 1 mln e 35 mijë euro bashkë me stafin.

■ ■ ■ TIRANE

DYLBER BALLA

Trajneri i ekipit kombëtar të futbollit Gianni De Biasi në një konferencë për mediat në FSHF ka folur për dy ndeshjet e fundit që Shqipëria do të zhvillojë përballë Zvicrës dhe Qipros duke i vlerësuar maksimalisht dhe deklaruar shpreson akoma për vendin e dytë, pasi matematika ia lejon. De Biasi i ka kërkuar Federatës Shqiptare të Futbollit një rritje prej 30% të kontratës, krahasuar me atë që ka firmosur dy vite më parë, kjo rritje shkon në 1 mln e 35 mijë euro bashkë me stafin.

### Si i vlerësoni dy ndeshjet e radhës me Zvicrën dhe me Qipron?

Kthehemi te ndeshja me Zvicrën pas dy ndeshjeve fatkeqe, dy humbjeve me Slloveninë dhe Islandën. Do t'i luajmë dy takimet e fundit me vendosmëri dhe me bindje që duhet të fitojmë. Kemi ndërtuar grupin dhe ky ka qenë objektivi ynë.

### A ka shpresë ende Shqipëria për vendin e dytë në grupin E?

Për sa kohe ka jetë ka dhe shpresë. Kemi dy ndeshje për të zhvilluar dhe matematika na lejon që të shpresojmë për kualifikimin, prandaj duhet që të marrim maksimumin përballë Zvicrës dhe Qipros.

### Si shpjegohet lënia jashtë kombëtares e Kappanit që po shkëlqen dhe thirrja e Agon Mehmetit që po luan shumë pak?

Kapllani dhe Salih janë dy futbollistë me karakteristika të njëjta dhe duhet të zgjidhja njërin mes tyre. Ndërsa për sa i përket Mehmetit dhe

### A keni komunikuar me Kaçen për problemet që po kalon me ekipin e tij në Greqi?

Po, kam biseduar me zëvendës presidentin e ekipit të PAOK. Futbollistit i kam dhënë mbështetje morale për të kapërcyer këtë moment. Personalisht më duket absurde që u krijua në një situatë e tillë, pasi shumë mirë mund të ishte shmangur që në fillim. Drejtuesit e ekipit të PAOK



bënë shumë gabim që lejuan të precipitonte një situatë e tillë.

### Cili reapt është më i dobët në kombëtare dhe a përputhet shiriti i kapitenit me liderin e ekipit?

Në kombëtare nuk ka një çështje 'kapiteni'. Cana ka besimin tim të plotë. Ndërsa për sa i përket reparteve, ky është një ekip i ri, i cili ka nevojë në të gjitha repartet që të konsolidohet çdo ditë e më shumë.

### Në kombëtare kemi vetëm futbollistë nga kampionatet e huaja dhe kosovarë, ndërsa nga kampionati shqiptar shumë pak, si shpjegohet?

Nuk dua të diskutoj çështjen që janë kosovarë apo shqiptarë, luajnë brenda apo jashtë, ajo që ka rëndësi për mua është që të marr më të mirët në qarkullim. I kam ndjekur ndeshjet e ekipeve shqiptare dhe futbollistët.

### Ndalem te kontrata, cila është diferenca mes asaj që kërkonte ju dhe

### asaj që ofron Duka?

Nuk ka një diferencë të madhe mes dy palëve. Jam në tratativë me FSHF për zgjatjen e kontratës, mungojnë vetëm disa detaje. Mund të them që jemi në rrugën e duhur, dëshira e të gjitha palëve është që të vazhdojmë sëbashku. Vullneti im është që të vazhdoj këtë aventurë.

### A keni marrë oferta nga ekipet tjera për t'u larguar nga Shqipëria?

Po, kam marrë disa oferta. Njëra prej të cilëve më ka ardhur para pak ditësh ndërsa tjetra në ditët e fundit. Jam duke vlerësuar ofertat, por dëshira është që të vazhdoj aventurën me Shqipërinë.

### Cfarë mund të thoni për grupin që kemi në dispozicion, ku mund të shkojmë?

Kur erdha në fillim të gjithë ishin skeptikë për kalimin e periudhës së tranzicionit, por ja sikur e shikojmë pas dy vitesh kemi ndërtuar një ekip të ri, simpatik me të ardhme. Kam shumë besim se me këta djem mund të kualifikohemi në Evropianin e 2016.

### Cfarë mund të thoni për Adnan Januzaj, a keni biseduar me të dhe cfarë oferte i keni bërë?

Me futbollistin nuk kam biseduar, por jemi duke e ndjekur me kujdes dhe duke përgatitur ofertën për të. Jemi në një pozicion shumë të vështirë, pasi kemi shumë pak shpresa që ai të luajë me ne, pasi Januzajt ia ka vënë syrin edhe Anglia, gjithashtu edhe Belgjika. Lojtari është mes dy ekipeve të mëdha, do jetë fitore e madhe që ai të pranohet Shqipërinë, nuk e ka shumë të lehtë, pasi këtu hyjnë në lojë dhe menaxherët.

### LAJME SHKURT

#### ■ **Sot dalin biletat për Zvicrën**

Sot do të dalin në treg biletat për ndeshjen Shqipëri-Zvicër. 16.179 bileta janë vendosur të hidhen në treg për ndeshjen e fundit të Shqipërisë brenda për këto eliminatore. Çmimi i tyre do të jetë i ngjashëm me ndeshjen e fundit me Norvegjinë. Tribuna përballë D2 do të kushtojë 3000 lekë, D1 dhe D3 nga 2000 lekë, anësore pas portave nga 500 lekë dhe tribuna A dhe B nga 5000 lekë. Biletat do të gjenden tek biletaaria tek stadiumi "Qemal Stafa" dhe tek "Rruga e Barrikadave". Ndeshja do të zhvillohet ditën e premte në mbrembje dhe pritet që interesi për këtë takim të jetë mjaft i madh.

#### ■ **Mexes dënohet 4 ndeshje pezullim**

Mbrojtësi i Juventusit, Giorgio Chiellini i ka bërë thirrje Komisionit të Disiplinës që mbrojtësi i Milanit, Philippe Mexes, të dënohet rëndë pas incidentit në derbin e të dielës. "Këto gjëra duhet që të dënohen rëndë, sepse nuk është e drejtë dhe kjo nuk është futbolli. Unë kam pasur po ashtu disa duele të ashpura, por jo kaq ashpër. Disa njerëz janë ofendues të vazhdueshëm. Përkushtimi duhet të jetë në nivel dhe duhet të lëvdohet, pasi që pas një duelle të rëndë ju shtrëngoni duart, por ajo që bëri Mexes nuk është futbolli", ka kritikuar Chiellini. Ndërsa Mexes është dënuar me 4 ndeshje pezullim.

#### ■ **Azia vendos orarin e 'El Clasico'**

'El Clasico' mes ekipit të Barcelonës dhe ekipit të Realit të Madridit është përcaktuar që të zhvillohet më datë 26 tetor në orën 18:00. Vendimi është marrë nga Federata Spanjolle e Futbollit duke pasur parasysh që ndeshja e parë derbi mes dy ekipeve me një rivalitet të vjetër dhe të ashpër të ndiqet maksimalisht edhe në Azi dhe në Amerikën Latine. Ndeshja do të zhvillohet në stadiumin 'Camp Nou' dhe pritet që përveç arenës në Barcelonë të ndiqet edhe nga mbi 100 mijë spektatorë në të gjithë botën anëmbanë.



NË FOTO: Gianni De Biasi





LAJME  
NGA BOTA

■ **Dëshmitarët "gozhdojnë" VIP-at e Agimit të Artë**  
Dëshmitarë në çështjen, e cila ka përfshirë javët e fundit mbarë Greqinë dhe opinionin gjatë dhe që ka të bëjë me Agimin e Artë e me veprimtarinë kriminale të kësaj organizate, duket se po u japin tjetër drejtim hetimeve në lidhje me neonazistët grekë. Dëshmi të një ish-neonazisti të larguar nga organizata bëjnë fjalë për stërvitjen ushtarake të falangave, rekrutimin dhe stërvitjen ushtarake të pasuesve, si edhe për përgatitjen e tyre ideologjike dhe përkushtimin që duhet të tregojnë. Sipas dëshmitarit, i cili, ka deponuar përpara prokurorit të çështjes, deputetët aktualë grekë, stërvisin ushtarakisht pasuesit e organizatës, në të ashtuquajturat "kampe rinore", në mënyrë të tillë, që me një goditje të thikës të shkaktonin vdekje të menjëhershme tek viktimat.

■ **Kosova nis pas disa ditësh negociatën për MSA**  
Në gjysmën e tetorit Kosova pritet të nisë negociatat për MSA-në, ndërkohë që sipas parashikimeve të Prishtinës zyrtare, qeveria ka synim t'i përfundojë ato deri në pranverën e vitit të ardhshëm. Sipas përlogaritjeve, MSA-ja do t'i kushtojë Kosovës 20 milionë euro, por ministria e Integritimit Vjora Çitaku thotë se, qytetarët do fitojnë 100 milionë të tjera. "Ne kemi bërë kalkulimet pas heqjes duke aluduar në trendet e tanishme dhe nuk do të ketë kosto më të madhe se 20 milionë euro në vit, ndërkohë që përfitimet e qytetarëve të Kosovës nga heqja e doganave 10% pritet të jetë 100 milionë euro para më shumë në xhepat e tyre", ka deklaruar Çitaku.

■ **Afganistan, presidenti Karzai: NATO dështoi**  
Presidenti i Afganistanit, Hamid Karzai, kritikoi NATO-n për dështim në misionin e ndërtimit të paqes dhe stabilitetit në vend, pavarësisht përpjekjeve të një dekade. "Në aspektin e sigurisë, misionet e NATO-s në Afganistan kanë shkakuar shumë vuajtje, shumë jetë të humbura dhe asnjë përfitim, pasi vendi nuk është i sigurt sot", deklaroi Karzai. Sipas tij, "strategjia e aleancës ka qenë e gabuar, pasi është përqendruar në ndjekjen e talebanëve në fshatra, në vend që të përqendrohej në luftimin e tyre në oazet e sigurta të rajoneve tribale të Pakistanit".

■ **Ish-presidenti francez lirohet nga akuzat**  
Rëzohet çështja penale kundër ish-presidentit francez, Nikolas Sarkozy për fondet e paligjshme të siguruar nga gruaja me e pasur e Francës, Lilien Bettencourt, gjatë fushatës për zgjedhjet presidenciale. Gazeta franceze "Le Monde" raporton se emri i tij është hequr nga lista e personave që do të dalin në gjyq për këtë çështje. Kjo i hap rrugën rikandidimit të tij në zgjedhjet e vitit 2017. Megjithatë ai nuk kishte mbështetje në përpjekjen e tij për t'u zgjedhur në vitin 2012, sondazhet tregojnë se Nikolas Sarkozy mund ta mundë presidentin Francois Hollande, në përplasjen e ardhshme.

■ **Sërish dhjetra viktimat në trazira në Egjipt**  
Ka shkuar në 50 numri i personave të vrarë gjatë përlëshjeve në Egjipt, mes forcave të sigurisë dhe mbështetësve të presidentit Muhammad Morsi. Aktet e dhunës u regjistruan dje në Kajro. Luftimet në rrugë shpërthyen mes islamistëve dhe përkrahësve të ushtrisë që kishin dalë për të festuar ditën kombëtare që shënon 40 vjetorin e luftës arabizo-izraelite. Të dyja palët qëlluan njëra-tjetër me gurë dhe shishe benzine. Policia përdori gazin lotsjellës për të shpërndarë përkrahësit e Mohamed Morsit.



abissnet®

ju sjellim lumturi  
në cdo stinë

Paketat	ADSL 2+				Fibër Optike
Shpejtësia	1 Mbps	2 Mbps	6 Mbps	8 Mbps	50 Mbps
Çmimi	900 Lekë	1,200 Lekë	1,400 Lekë	2,000 Lekë	5,500 Lekë

\* Paketat janë pa limit. Instalimi ofrohet falas.  
Çmimet janë të vlefshme për parapagimet 1 vjeçare. TVSh e përfshirë në çmim.

Rr. Ismail Qemali, ish Blloku. Tiranë  
Tel: 044300123

www.abissnet.al  
sales@abissnet.al

• Alba Malltezi  
Drejtoreshë e Përgjithshme  
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha  
Drejtoreshë e Shqiptarja.com

• Genc Kondi  
Zv. Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena

Aktualitet: Jonida Aliu  
Ekonomia: Genc Kondi  
Social: Esmeralda Keta  
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj  
Genti Manelli  
Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:  
Saimir Zenelaj  
cel: +355696060418  
cel: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë